



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.106, Datë 27.02.2020

PËR

VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN PËRFUNDIMTAR TË KANDIDATIT Z.{...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 27.02.2020, në kuadër të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e tij nr. 110, datë 09.07.2019, pas përfundimit të intervistës me kandidatin z. {...}, bazuar në të dhënat që rezultuan nga intervista, sikundër edhe nga të dhënat e rezultuara nga dokumentet e paraqitura nga kandidati dhe ato të administruara gjatë procedurës së përzgjedhjes, mbasi shqyrtoi projekt vendimin “Për vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit z. {...}” përgatitur nga relatori i çështjes,

VËREN

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, sipas shkronjës “c”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Me Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në *fushën e të drejtës penale*.

3. Për pozicionin e lirë të shpallur si më lart, brenda afatit të përcaktuar, ka aplikuar edhe kandidati z. {...}.

4. Për kandidatin z. {...}, sikundër edhe për kandidatët e tjerë, fillimisht Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit dhe, në përfundim, me Vendimin nr. 256, datë 12.11.2019, vendosi: *“Kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z. {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*.

5. Ndërkohë, me Vendimin nr. 261, datë 13.11.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: *“Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*. Në këtë rast, Këshilli, përmes shortit, ka caktuar dhe relatorin për këtë procedurë përzgjedhjeje për emërim në Gjykatën e Lartë.

6. Në kuadër të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, në zbatim të nenit 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Vendimit të tij nr. 102, datë 05.07.2019 “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 102/2019), si dhe të Vendimit të tij nr. 209, datë 11.10.2019 “Për miratimin e “Metodologjisë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë” (më poshtë referuar si Metodologjia e Vlerësimit dhe Pikëzimit), Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.103, datë 26.02.2020, miratoi vlerësimin dhe pikëzimin paraprak për kandidatin z. {...}. Sipas këtij vendimi, kandidati është vlerësuar dhe pikëzuar paraprakisht me 86 pikë në total.

7. Në vijim të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, pas vlerësimit dhe pikëzimit paraprak, në zbatim të pikës 7, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sikundër dhe Vendimit të tij 102/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi me kandidatin z. {...} një intervistë, në një seancë publike, më datë 27.02.2020.

8. Gjatë intervistës, kandidati u pyet nga Këshilli, duke marrë nga ai përgjigjet në lidhje me: motivet dhe arsyet që e kanë shtyrë për të kandiduar për në Gjykatën e Lartë, duke specifikuar dhe objektivat që kishte nëse emërohej gjyqtar i kësaj gjykate; elementët e formimit dhe të eksperiencës së tij që, sipas opinionit të tij, e kishin përgatitur për të adresuar çdo aspekt në lidhje me juridiksionin e Gjykatës së Lartë; rolin e Gjykatës së Lartë në shoqëri, sfidat përpara saj dhe strategjia e tij për kapërcimin e tyre; masat konkrete që mund të merren për reduktimin e “backload”-it në Gjykatën e Lartë; dhe dilemën etike më sfiduese që kishte pasur në jetë dhe mënyrën si e kishte zgjidhur atë.

9. Pas intervistës me kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vijoi shqyrtimin dhe vendosi në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit për secilën kategori, kriter, nënkriter

dhe tregues, të përcaktuar në pikën 6, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të detajuara më tej në Vendimin e tij 102/2019, ku përcaktohen në detaje ndarja e kategorive të vlerësimit në kritere, nënkritere dhe treguesit vlerësues për pikëzimin, pikëzimi maksimal për secilin nga ato, burimet dokumentare dhe disa të dhëna për metodologjinë në funksion të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Pikëzimit, ku shpjegohen orientimet që mban parasysh Këshilli në vlerësimin dhe caktimin e pikëve për secilën kategori të meritave të kandidatit, kriter, nënkriter apo tregues të tyre.

10. Sipas akteve normative të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë vlerësohet dhe pikëzohet për tre kategori vlerësimi, të cilat me tej detajohen në kritere, nënkritere apo tregues/indikator, ku secila nga këto vlerësohet dhe pikëzohet.

11. Kategoria e parë e vlerësimit është “Meritat profesionale”. Kjo kategori vlerësimi ndahet në tre kritere, të cilët nga ana tjetër ndahen në nënkritere dhe një prej tyre edhe në tregues.

12. Kriteri i parë i Kategorisë “Meritat profesionale”, është “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”. Ky kriter vlerësimi ndahet në pesë nënkritere, e më konkretisht:

- a) “Historiku arsimor” ose “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi”;
- b) “Rezultatet e programeve të formimit fillestar”;
- c) “Rezultatet e përvojës në profesion”;
- ç) “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”
- d) “Aftësitë gjuhësore.

13. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Historiku arsimor” ose “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi”:

13.1 Neni 49, pika 6, shkronja “c”, i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi i Këshillit 102/2019 i dalë në zbatim të ligjit, përcaktojnë si nënkriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe “*rezultatet e studimeve të larta për drejtësi*”. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, nënkriteri “Historiku arsimor” apo “Rezultatet e studimeve të larta për drejtësi” vlerësohet dhe pikëzohet deri në 2 pikë, duke iu referuar mesatares së notave jo më pak se 8, ose të barasvlershme me të, nëse studimet janë përfunduar jashtë vendit. Për vlerësimin e kandidatëve caktohet 1 pikë, duke filluar nga mesatarja e notave 8.

13.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka ndjekur studimet universitare dhe për këtë u administruan:

- Diplomë nr. 1650 B, me nr. regjistri 1356, lëshuar më datë 25.06.1986, nga Universiteti i Tiranës, sipas të cilit kandidati, në periudhën 1982 - 1986, ka kryer kursin e plotë të Fakultetit të Shkencave Politike e Juridike të Universitetit të Tiranës në Degën “Drejtësi” dhe me Vendim të Komisionit Shtetëror të datës 25.06.1986 i është dhënë titulli “Jurist”;
- “Lista e Rezultateve të Provimeve”, lëshuar më datë 05.07.1986, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike.

13.3 Sipas dokumenteve të administruara, kandidati z. {...} ka përfunduar studimet e larta për drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës dhe është diplomuar “jurist” në vitin 1986. Referuar Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, arsimi i kandidatit kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Ndërkohë, sipas listës së rezultateve të provimeve, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, sikundër edhe nga vetëdeklarimi i kandidatit në jetëshkrimin e tij, rezulton se mesatarja e studimeve të tij universitare 4-vjeçare është 9,4.

13.4 Ndaj nga sa rezultoi, për nënkriterin e vlerësimit “Historiku arsimor” apo “Rezultatet e studimeve të larta për drejtësi”, duke patur parasysh notën mesatare të studimeve në drejtësi të kandidatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

14. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Rezultatet e programeve të formimit fillestar”:

14.1 Neni 49, pika 6, shkronja “c”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Vendimi 102/2019, përcaktojnë si nënkriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe “*rezultatet e programit fillestar*”. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, në programet e formimit profesional përfshihen Shkolla e Magjistraturës, Shkolla e Avokatisë, Shkolla e Administratës Publike, etj., të cilat kontribuojnë në rritjen e profesionalizmit. Me anë të këtij nënkriteri vlerësohet niveli i rezultateve të angazhimit të kandidatit në ndjekjen e veprimtarive të kualifikimit fillestar profesional që mundësojnë arritjen e një profesionalizmi më të lartë në shërbim të ushtrimit të funksioneve dhe detyrave profesionale. Për këtë nënkriter Këshilli cakton 1 pikë për rezultatet e studimeve të vlerësuara një nivel më të ulët se niveli maksimal (“*mirë*” ose “*shumë mirë*”, sipas programit) dhe 2 pikë për rezultate të vlerësuara në nivelin maksimal (“*shumë mirë*” ose “*shkëlqyeshëm*”, sipas programit).

14.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati {...} nuk rezulton të ketë ndjekur programe të formimit fillestar të tilla si Shkolla e Magjistraturës, Shkolla e Avokatisë, Shkolla e Administratës Publike etj.

14.3 Ndaj nga sa rezultoi, për nënkriterin e vlerësimit “Rezultatet e programit fillestar”, duke patur parasysh se kandidati nuk ka ndjekur programe të formimit fillestar, Këshilli i Lartë

Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 0 pikë.

15. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Rezultatet e përvojës në profesion”:

15.1 Neni 49, pika 6, shkronja “c”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/2019, përcaktojnë si nënkriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe “*rezultatet e përvojës në profesion*”. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, me anë të këtij nënkriteri vlerëzohet niveli i rezultateve të arritura gjatë përvojës së kandidatit në profesionin e juristit. Duke marrë parasysh të dhënat dhe informacionet në dispozicion, Këshilli cakton 2 pikë për rezultatet e arritura gjatë përvojës profesionale si jurist të vlerësuara një nivel më të ulët se niveli maksimal (“mirë” ose “shumë mirë”, sipas llojit të profilit) dhe 4 pikë për rezultatet e vlerësuara në nivelin maksimal (“shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm”, sipas llojit të profilit). Për kandidatët për të cilët nuk ka vlerësime nga sisteme zyrtare vlerësimi, do të merren për bazë opinionet vlerësuese të strukturave drejtuese të organizmave ku ata bëjnë pjesë (*si për shembull departamenti ose dekanati, dhoma e avokatisë, dhoma e noterëve, dhoma e ndërmjetësuesve etj.*).

15.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z.{...} ka përvojë të gjatë si jurist, ndërsa për rezultatet e përvojës në profesion u administruan disa opinione vlerësuese të strukturave drejtuese të organizmave ku ai ka bërë ose bën pjesë, e më konkretisht:

- Vlerësimi datë 17.07.2019, i Rektorit të Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti”, Prof. Dr. {...}, i konfirmuar edhe me Shkresën e këtij Institucioni nr.2695 prot., datë 09.08.2019. Sipas këtij opinioni vlerësues: “... *Gjatë karrierës së tij si pedagog, Z.{...}ka mbuluar mësimdhënien në lëndet e fushës penale, kryesisht në lëndë të tilla si Procedura Penale, E Drejta Penale, Organizimi Gjyqësor, etj. Në institucion ... është i përfshirë si personel akademik me orientim mësimor dhe kërkimor, ... / Ai është aktivizuar dhe ka kontribuar në të gjitha aktivitetet shkencore që ka organizuar institucioni duke treguar profesionalizëm, përgjegjshmëri dhe përpikmëri. Që nga viti 2012 ai është anëtar i Këshillit Shkencor të Revistës “Gjeopolitika”, organ i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”. / Përveç mësimdhënies, Dr.{...} drejton Departamentin e Drejtësisë në këtë institucion. Gjatë punës si drejtues i Departamentit ka treguar aftësi organizative, drejtuese dhe vizion të qartë për mbarëvajtjen e punës. / Si anëtar i Senatit të institucionit, ai ka kontribuar me përvojën dhe profesionalizimin e tij në diskutime dhe në vendimmarrjet përkatëse. / Dr.{...} ka dhënë kontribut të veçantë në hartimin e akteve ligjore të institucionit; në mënyrë të veçantë, atij i është besuar hartimi i draftit themelor të Statutit në zbatim të dhe në përputhje me ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. / Ndër detyrat që mbulon Dr. {...} është edhe pjesëmarrja e tij si anëtar dhe Kryetar i Këshillit të Etikës së institucionit. Ai gëzon respektin e trupës së pedagogëve, të studentëve*

dhe të stafit të institucionit. / Gjej rastin të shpreh përshtypjet e mia shumë të mira për personalitetin, kulturën profesionale dhe veprimtarinë e z. {...}si dhe aftësitë e shënuara të komunikimit njerëzor dhe akademik me të gjithë personelin në institucion”;

- Vlerësimi datë 26.07.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Shoqërisë “Intesa SanPaolo Bank” sh.a, z. Silvio Pedrazzi. Sipas këtij opiniononi vlerësues: *“Zoti {...} është anëtar i Bordit të Drejtuesve të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. që prej vitit 2014. Në mbledhjet e Bordit ai ka vepruar me përpikmëri, disiplinë dhe etikë profesionale, duke ndikuar në mbarëvajtjen e punës. Përveç Zotit {...}, Bordi i Drejtuesve të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. përbëhet nga anëtarë të huaj dhe për këtë arsye gjuhët e punës janë anglishtja dhe italishtja”;*
- Vlerësimi datë 28.10.2019, i Kryetarit të Bordit të Akreditimit të Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), Prof. {...} (PhD). Sipas këtij opiniononi vlerësues: *“... Me pjesëmarrjen e tij në Bordin e Akreditimit, z. {...} ka dhënë një kontribut profesional dhe të pazëvendësueshëm, që ka ndikuar në vendimmarrjen kolegjiale dhe në përputhje me ligjin të kësaj trupe, e cila realizon procesin përfundimtar të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë. / Në punimet e Bordit të Akreditimit, si një organizëm kolegjial me përbërje anëtarësh nga disiplina dhe kultura të ndryshme, zoti {...} ka treguar aftësi shumë të mira profesionale dhe komunikuese. Bordi i Akreditimit përbëhet nga ekspertë të huaj dhe shqiptarë, personalitete në fushën e arsimit të lartë dhe sigurimit të cilësive e dhe gjuha e punës që përdoret në mbledhjet e tij është gjuha angleze, të cilën zoti {...} e zotëron në nivele të larta. / Përveç pjesëmarrjes në mbledhjet e Bordit, zoti {...} ka kontribuar edhe me pjesëmarrjen e tij aktive në çështje dhe aktivitete të tjera të organizuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Bordi i Akreditimit, ndër të tjera edhe në përgatitjen e akteve nënligjore dhe vendimeve model të Bordit, në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, sidomos të atyre akteve që lidhen me organizimin dhe vendimmarrjen për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit. / Së fundmi, e ndjej një privilegj të shkruaj këtë referencë. Ne, si Bord i Akreditimit, dhe unë personalisht, kemi përfitur pa masë nga njohuritë, integriteti, profesionalizmi dhe kolegjialiteti i zotit {...}. Besoj dhe shpresoj që edhe Ju të përfitoni të njëjtin përkushtim dhe kontribut”;*
- “Vlerësimi i Produktit për Konsulentë dhe Kontraktorë Individual i UNICEF”. Sipas këtij Vlerësimi, në Seksionin Dy, puna në cilësi dhe në kohë e kandidatit vlerësohet si “pozitiv”, kurse, në Seksionin Tre, produkti i punës vlerësohet si “plotësisht i arritur”. Në Komentet Shtesë të Supervizorit përshkruhet se: *“Konsulenti provoi se ishte një kryetar grupi i dalluar për hartimin e projektit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, një prezantues dhe advokues shumë i mirë në takimet konsultative, një profesionist ligjor, njohës shumë i*

mirë i aspekteve të drejtësisë penale, një draftues tepër i përpiktë dhe një konsulent që i përgjigjet sfidave lidhur me afatet”.

15.3 Sipas dokumenteve të administruara, opinioneve vlerësuese të drejtuesve të institucioneve, subjekteve dhe organizatave si më lart, ku kandidati ka marrë pjesë, rezultoi se kandidati ka dhënë kontribut për çdo detyrë që i është ngarkuar, ka treguar profesionalizëm, përgjegjshmëri dhe përpikmëri. Larmishmëria e eksperiencave e shoqëruar me rezultate të shkëlqyera në punë, justifikojnë vlerësim maksimal të kandidatit për këtë nënkriter. Vlen të përmendet veç përvojës së mësimdhënies dhe avokatisë, kontributi specifik i kandidatit në hartimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit si dhe Dokumentit Strategjik për një Drejtësi Miqësore për të mitur, kontributi i tij si arbitër në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv, si anëtar i Bordit të Akreditimit të Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si anëtar i Bordit Drejtues të Intesa SanPaolo Bank sh.a., apo ai i konsulencës pranë UNICEF, e pjesëmarrjes në shumë grupe pune multidisiplinore. Po ashtu, kandidati ka treguar aftësi organizative dhe drejtuese e vizion të qartë në mbarëvajtjen e punës. Me përkushtimin e tij kandidati ka dhënë kontribut të qenësishëm në secilën prej sipërmarrjeve që ka marrë përsipër.

15.4 Ndaj nga sa rezultoi, për nënkriterin e vlerësimit “Rezultatet e përvojës në profesion”, pasur parasysh përfundimet e arritura nga dokumentacioni i administruar, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 4 pikë.

16. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”:

16.1 Neni 49, pika 6, shkronja “c”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/209, përcaktojnë si nënkriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe “*rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë*”. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit ky nënkriter është zbrëthyer në tre tregues, e konkretisht:

- i) “Rezultatet e trajnimeve të tjera”;
- ii) “Rezultate e kualifikimeve pasuniversitare”;
- iii) “Rezultatet e gradave/titujve shkencorë”.

16.2 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, për vlerësimin dhe pikëzimin e këtij nënkriteri, Këshilli vlerëson: i) “Rezultatet e trajnimeve të tjera” - deri në 2 pikë; ii) “Kualifikimet pasuniversitare” - deri në 3 pikë [2 pikë për studime, me rezultate të larta (1 pikë për mesatare 8-9; 2 pikë për mesatare 9.1-10) të kryera në Shqipëri, dhe deri në 3 pikë (1.5 pikë për mesatare 8-9; 3 pikë për mesatare 9.1-10) nëse studimet janë kryer në vendet e BE/OECD]; si dhe iii) “Gradat shkencore dhe titujt akademikë” - deri në 4 pikë [për rezultatet e larta, 95-100 pikë, ose

ekuivalente, gjatë studimeve të doktoraturës në drejtësi, Këshilli cakton deri në 2 pikë nëse grada shkencore “Doktor” është kryer në Shqipëri, dhe deri në 3 pikë nëse grada shkencore është kryer në vendet e BE/OECD; për titullin akademik “Profesor i asociuar”, duke marrë parasysh fushën dhe institucionet e punësimit, Këshilli cakton deri në 2 pikë nëse kandidati e ka fituar titullin akademik në Shqipëri, dhe deri në 3 pikë nëse kandidati e ka fituar atë në vendet e BE/OECD; për titullin akademik “Profesor ose Professor Emeritus”, duke marrë parasysh fushën dhe institucionet e punësimit, Këshilli cakton deri në 3 pikë nëse kandidati e ka fituar titullin akademik në Shqipëri, dhe deri në 4 pikë nëse kandidati e ka fituar atë në vendet e BE/OECD]. Në çdo rast, totali i pikëve të caktuara nuk mund të jetë më i lartë se maksimumi i pikëve për këtë kriter - 8 pikë. Për të realizuar një vlerësim sa më objektiv të kandidatëve që kanë tituj akademikë, grada shkencore, apo që kanë kryer studime të tjera afatgjata, mastera ekzekutivë dhe trajnime të tjera, mbahen në konsideratë edhe kriteret e përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë (Ligjin nr. 80/2015). Në lidhje me trajnimet e realizuara referuar Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, trajnimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, për efekt vlerësimi, duhet që të jenë të 10 (dhjetë) viteve të fundit.

16.3 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka ndjekur një sërë trajnimesh të tjera, ka kryer studime pasuniversitare, si dhe ka gradë shkencore në drejtësi.

16.4 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Trajnime të tjera”:

16.4.1 Për treguesin “Trajnime të tjera”, referuar jetëshkrimit, rezultoi se kandidati ka kryer trajnime të tjera si mëposhtë:

- Mars 1993 (tre javë), në kuadrin e Programit “Tempus”, si pedagog i jashtëm i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, trajnim nga Fakulteti i Jurisprudencës, Universiteti i Trentos, Itali. Në këtë kualifikim nuk është lëshuar dokument;
- Viti 2003, program kualifikimi për Magjistratë, organizuar nga CSM (Superior Council of Magistracy), në Romë, Itali, trajnim nga Consiglio Superiore della Magistratura (Këshilli i Lartë i Magjistraturës). Në këtë kualifikim nuk është lëshuar dokument;
- Viti 1998 dhe 1999 (një javë), program trajnimi “Trajnim i trajnuesve” i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, organizuar në Varshavë (Poloni). Në këtë kualifikim nuk është lëshuar dokument;
- Viti 1994 (një javë) dhe viti 1998 (dy javë), program kualifikimi për Magjistratë, organizuar nga UNICRI. Në këtë kualifikim nuk është lëshuar dokument;
- Viti 1995 (tre javë), program trajnimi mbi “Common Law”, organizuar nga Lord Chancellor Department, në Londër në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë. Në këtë kualifikim nuk është lëshuar dokument.

16.4.2 Sipas dokumentacionit të administruar, trajnimet si më lart të kryera jashtë Shqipërisë nga kandidati z. {...}, datojnë më shumë se 10 vite përpara kandidimit.

16.4.3 Ndaj nga sa rezultoi, për treguesin e vlerësimit “Rezultatet e trajnimeve të tjera”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 0 pikë.

16.5 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare”:

16.5.1 Për treguesin e vlerësimit “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare”, referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka kryer kualifikim pasuniversitar dhe për këtë u administrua Vërtetimi datë 23.04.2009, i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, nëpërmjet të cilit vërtetohet se kandidati ka ndjekur, në vitet 2004-2005, kualifikim pasuniversitar “Master në Shkencat Penale” dhe se, më datë 05.12.2005, kandidati ka mbrojtur mikrotezën me titull “Organizimi gjyqësor në lëndën penale në Republikën e Shqipërisë” dhe është vlerësuar me 98 pikë (“shumë mirë”), duke iu akorduar titulli ‘Master në Shkencat Penale’. Për këtë, kandidati është pajisur me “Diplomë Master”.

16.5.2 Ndaj nga sa rezultoi, për treguesin e vlerësimit “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare”, duke patur parasysh notën mesatare të kualifikimit pasuniversitar, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

16.6 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Gradat shkencore dhe titujt akademikë”:

16.6.1 Për treguesin e vlerësimit “Gradat shkencore dhe titujt akademikë”, referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka marrë gradë shkencore në drejtësi dhe për këtë u administrua Vendimi nr. {...}, datë {...}, i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, sipas të cilit, në vitet 2009-2011, kandidati ka ndjekur studimet në këtë Fakultet, duke marrë gradën shkencore “Doktor” në të drejtën Penale, pasi ka mbrojtur përpara jurisë punimin me temë: “Organizimi gjyqësor në lëndën penale në Republikën e Shqipërisë”, ku pas përfundimit të procedurës së mbrojtjes dhe të votimit, kandidati është vlerësuar me rezultatin “Shumë mirë”, me *99 pikë nga 100*.

16.6.2 Ndaj nga sa rezultoi, për treguesin e vlerësimit “Gradat shkencore dhe titujt akademikë”, duke patur parasysh rezultatin e gradës shkencore në drejtësi të kandidatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se ai duhet të vlerësohet me 2 pikë.

16.7 Për rrjedhojë, për nënkriterin “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 4 pikë në total.

17. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Aftësitë gjuhësore”:

17.1 Neni 49, pika 6, shkronja “ç”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/2019 dalë në zbatim të ligjit, përcaktojnë si nënkriter për të vlerësuar aftësitë profesionale të kandidatëve edhe “*aftësitë gjuhësore*”. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, nënkriteri “Aftësitë gjuhësore” vlerësohet dhe pikëzohet deri në 4 pikë, duke mbajtur parasysh njohjen nga kandidatët të pesë gjuhëve të huaja anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Për këtë, Këshilli vlerëson dhe pikëzon me përparësi njohuritë në gjuhët angleze dhe franceze, ku në varësi të shkallës së zotërimit, kandidati vlerësohet deri në 1,5 pikë për secilën gjuhë. Po ashtu, Këshilli vlerëson dhe pikëzon edhe njohuritë në gjuhët e tjera të deklaruara nga kandidati, për të cilat ai nuk testohet me kushtin që të jenë të shoqëruara me dokumente vlerësuese të vlefshme për nivelin e njohurive të tyre. Për gjuhët e tjera, të ndryshme nga anglishtja dhe frëngjishtja, kandidatit i shtohet deri një 1 pikë. Po sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, vlerësimi i kandidatit për shkallën e zotërimit të gjuhës së huaj bazohet në: *testet ndërkombëtare, sipas Ligjit nr. 80/2015 dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit nr. 52, datë 03.12.2015; ose mendimin me shkrim të dhënë nga ekspertët, të cilët, pas intervistës që zhvillohet me kandidatin për këtë qëllim, japin vlerësimin e tyre për nivelin njohjes së gjuhës së huaj.*

17.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar, rezultoi që kandidati {...} zotëron dy gjuhë të huaja, Anglisht dhe Italisht dhe për këtë u administruan:

- Dëshmi e mbrojtjes së gjuhës angleze e datës 13.05.1995, e lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, ku rezulton se është vlerësuar me notën 8 (tetë);
- Dëshmi e mbrojtjes së gjuhës italiane e datës 04.03.1992, e lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, ku rezulton se është vlerësuar me notën 8 (tetë);
- Shkresa e Shoqërisë “Intesa SanPaolo Bank”, e datës 26.07.2019;
- Shkresa e Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), e datës 26.07.2019;
- Të dhëna të tjera të lidhura me pjesëmarrje në projekte të ndryshme të organizatave ndërkombëtare, si UNICEF Albania, Fondacioni “Save The Children”, Zyra e Këshillit të Europës Shqipëri etj.

17.3 Sa i përket shkallës së zotërimit nga kandidati të dy gjuhëve të huaja si më lart, një gjë e tillë nuk rezultoi sipas alternativës së parë të vlerësimit, pra bazuar në testet ndërkombëtare, sipas Ligjit nr. 80/2015 dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit nr. 52, datë 03.12.2015, pasi testimi dhe mbrojtja nga ai i gjuhëve të huaja daton në vitet 1992 dhe 1995. Në Ligjin nr. 80/2015 dhe Udhëzimin e Ministrit të Arsimit nr. 52, datë 03.12.2015 nuk parashikohet konvertimi i mbrojtjes së gjuhës së huaj dhënë përpara Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të Universitetit të Tiranës, në nivele

ndërkombëtare të njohjes së gjuhës së huaj (*kurdoherë kërkohet që mbrojtja të bëhet bazuar në testet ndërkombëtare*). Nga ana tjetër, Këshilli çmoi jo relevante thirrjen e ekspertit/përkthyes për të vlerësuar shkallën e zotërimit të gjuhëve të huaja nga kandidati, në kushtet kur ai mbeti i kandidati i vetëm në procedurën e përzgjedhjes për emërim. Megjithatë, në kushtet kur përmes certifikatave të lëshuara nga një institucion publik i profilizuar i arsimit të lartë vërtetohej që kandidati të ketë mbrojtur dy gjuhët e huaja si më lart (anglisht dhe italisht) shumë vite më parë, si dhe kur vërtetohej përdorimi nga ai, ndër vite dhe aktualisht, i këtyre gjuhëve të huaja, duke mbajtur parasysh vlerësimin në momentin e mbrojtjes së gjuhës angleze dhe mungesën e një vlerësimi aktual, Këshilli çmoi ta vlerësoj kandidatin z. {...} me 1 pikë për njohuritë e tij në gjuhën angleze, duke i shtuar 1 pikë tjetër për njohuritë në gjuhën italiane.

17.4 Për rrjedhojë, për nënkriterin e vlerësimit “Aftësitë gjuhësore”, duke vlerësuar të gjitha të dhënat e administruara në harmoni me njëra-tjetër, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 2 pikë në total.

18. Përfundimisht, sa më sipër, për kriterin e vlerësimit “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 12 pikë në total.

19. Kriteri i dytë i Kategorisë “Meritat profesionale”, është “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”. Ky kriter vlerësimi ndahet në pesë nënkritere/indikatore/tregues, e më konkretisht:

- a) “Origjinaliteti dhe/ose impakti”;
- b) “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”;
- c) “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”;
- ç) “Interpretimi i harmonizuar”;
- d) “Referencat e praktikës gjyqësore”.

20. Neni 49, pika 6, shkronja “b”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/2019 dalë në zbatim të ligjit, përcaktojnë si kriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe vlerësimin e punës së kandidatit, përmes të paktën pesë dokumenteve ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë përvojës së tij në profesion gjatë pesë viteve të fundit, si dhe çdo publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit. Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, vlerësimi për këtë kriter bëhet përmes vlerësimit cilësor të pesë punimeve dhe dokumenteve profesionale gjatë pesë viteve të fundit të karrierës. Po ashtu, elemente shtesë mbi cilësinë e rezultateve profesionale mund të nxirren edhe nga dokumentet zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional të paraqitura nga kandidati ose të kërkuara nga ana e Këshillit prej autoriteteve përkatëse, si edhe dokumentet zyrtare që paraqesin cilësinë dhe arrijtet gjatë eksperiencës në punë, nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky kriter, pra “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”, synon të identifikojë ata kandidatë të cilët kanë performuar në mënyrë të dalluar në fushën përkatëse të ushtrimit të

profesionit, prandaj vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatëve bëhet duke u mbështetur në arritjen e rezultateve më të larta dhe të dallueshme profesionale, të konsideruara në përgjithësi, për të vlerësuar cilësinë e aftësive profesionale. Referuar Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, secilin nga pesë treguesit (“Origjinaliteti dhe/ose impakti”; “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”; “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”; “Interpretimi i harmonizuar”; “Referencat e praktikës gjyqësore”) vlerësohet dhe pikëzohet në maksimum me 5 pikë, e në total vlerësimi cilësor vlerësohet në maksimum me 25 pikë.

21. Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar, rezultoi që kandidati {...} ka përgatitur botime në cilësinë e autorit apo të bashkëautorit, ka përgatitur publikime profesionale dhe kërkime shkencore, si dhe artikuj të tjerë profesional, si brenda dhe jashtë vendit, të cilat janë të fokusuara në shumicën e rasteve në fushën e të drejtës penale dhe asaj procedurale penale, në fushën institucionale të pushtetit gjyqësor, në drejtësinë sportive e më gjerë.

22. Gjatë procedurës së përzgjedhjes u administruan pesë dokumente ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë pesë viteve të fundit, e më konkretisht:

- 1) “Dokument Strategjik mbi Drejtësinë Miqësore për të Mitur” (Paraprirë nga termat e referencës së UNICEF) (Për të informuar dhe sugjeruar procesin e përgatitjes së Strategjisë së Reformës së Sistemit të Drejtësisë për Drejtësinë Penale dhe për Financimin e Sistemit të Drejtësisë) - përgatitur nga kandidati si konsulent profesional, në bashkëpunim me UNICEF;
- 2) “Projekt i kapitujve V-VII të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur” (Paraprirë nga Vlerësimi i punës për konsulentin, nga UNICEF) (Në kuadrin e përgatitjes së projektit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur) (Për reformën në Sistemin e Drejtësisë) - përgatitur nga kandidati, në cilësinë e ekspertit, në kuadër të hartimit të Projektit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pjesë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë”;
- 3) “Mendim - Për punimin e përgatitur nga kandidati për magjistrat {...} dhe vlerësimi përkatës” - përgatitur nga kandidati, në cilësinë e pedagogut, me kërkesë të Shkollës së Magjistraturës, në rolin e udhëheqësit të temës së përzgjedhur nga kandidati për magjistrat në përfundim të studimeve të vitit të dytë pranë Shkollës së Magjistraturës;
- 4) “Recensë - Për librin “Koment i Procedurës Penale”, me autor gjyqtarin {...} - përgatitur nga kandidati, në cilësinë e ekspertit, me kërkesë të Shkollës së Magjistraturës, për dhënien e një vlerësimi për këtë libër;
- 5) Statut i Universitetit “Marin Barleti”-Projekt - përgatitur nga kandidati, në cilësinë e ekspertit, me kërkesë të Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti”, në kuadër të hartimit të Projekt-Statutit të këtij institucioni të arsimit të lartë në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

23. Gjatë procedurës së përzgjedhjes u administruan edhe dokumente të tjerë ligjore të kandidatit, e më konkretisht:

- 1) “Manual - Për të drejtat e personave të arrestuar, të ndaluar apo të shoqëruar dhe respektimi i tyre nga policia e shtetit (Manual për punonjësit e Policisë së Shteti) (Për Institutin Evropian të Tiranës dhe Akademinë e Sigurisë) - përgatitur nga kandidati në cilësinë e ekspertit;
- 2) “Prezantim - Drejtësia Penale për të Mitur (Për studentët e formimit fillestar në Shkollën e Magjistratrës, në lëndën - Procedurë Penale) - përgatitur nga kandidati në cilësinë e pedagogut;
- 3) “Mendim - Për punimin e përgatitur nga kandidati për magjistrat Suela Lika dhe vlerësimi përkatës” (Për Shkollën e Magjistraturës) - përgatitur nga kandidati në cilësinë e pedagogut;
- 4) “Vendime” dhe “Opinion”, të Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) - përgatitur nga kandidati në cilësinë e arbitrit;
- 5) “Drejtësia sportive në Shqipëri” - Ekstrakt nga Libri “Sistemi sportiv” (Pjesë e Programit të lëndës mësimore “Sistemi Sportiv) (Për Shkollën e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti”) - përgatitur nga kandidati në cilësinë e pedagogut;
- 6) “Projektvendime” dhe “Mendim” (Për Bordin e Akreditimit pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë) (Paraprirë nga shkresa e Kryetarit të Bordit të Akreditimit) - përgatitur nga kandidati në cilësinë e anëtarit të këtij organi kolegjal, që përbëhet nga 11 anëtarë, që janë personalitete të botës akademike me nje eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- 7) “Gjyq pa gjyqtar” - Pjesë e shkëputur nga leksionet në lëndën Procedurë Civile, në Shkollën e Lartë Universitare Jopublike “Universitetit Marin Barleti”) (Për Shkollën e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti”) - përgatitur nga kandidati në cilësinë e pedagogut.

24. Gjatë procedurës së përzgjedhjes u administruan edhe disa Botime të kandidatit, e më konkretisht:

- 1) Procedura Penale - Komentar (Criminal Procedure - Commentary) - Botim në gjuhën shqipe dhe angleze (Bashkëautorësi me {...} dhe {...});
- 2) “Organizimi Gjyqësor në lëndën penale në Republikën e Shqipërisë” - Libër monografik;
- 3) “Të drejtat e personave të arrestuar, të ndaluar apo të shoqëruar dhe respektimi i tyre nga policia e shtetit” - Manual trajnimi. Tiranë 2014, Instituti Evropian i Tiranës (Bashkëautorësi me {...});
- 4) “Raport mbi Studimin e Përqasjes së Legjislacionit Shqiptar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut” - Tiranë, Qershor 2003 - Botim i Komisionit Evropian dhe Ministria e Drejtësisë;
- 5) “Sistemi Sportiv” - Tekst Universitar (Botuar nga “Botimet Dudaj”, Tiranë 2019 (Bashkëautorësi me Prof. Dr. {...}).

25. Gjatë procedurës së përzgjedhjes u administruan edhe disa artikuj shkencorë në fushën e së drejtës, të botuar në revista shkencore dhe profesionale, e më konkretisht:

- 1) “Rruga e “gjatë” dhe e “mundimshme” e vendimit nga shpallja deri në dorëzimin e tij” - Botuar në Revistën “Jeta Juridike” nr. 1, Mars 2015, botim i Shkollës së Magjistraturës, Tiranë. (The “long” and “difficult” way of the decision from notification up to handling (Botuar edhe në gjuhën angleze);
- 2) “Aspekte të jurisprudencës kushtetuese për çështjen e pakicave” - Botuar në Revistën Gjeopolitika”, nr. VIII, 2013, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, Tiranë;
- 3) “Vendi dhe roli i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që nga Kushtetuta e vitit 1998. Përgjegjësia për të ndërtuar një gjyqësor të përgjegjshëm e të pavarur” - Botuar në Revistën “Mendimi” (Studime në Jurisprudencë dhe Ekonomi) nr. 1, viti 2013;
- 4) “Aspekte aktuale të pushtetit gjyqësor në Shqipëri dhe të perspektivës integruese” - Botuar në Revistën “Gjeopolitika”, nr. VIII, 2012, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, Tiranë;
- 5) “Roli dhe pozita e Presidentit të Republikës së Shqipërisë në drejtimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” - Botuar në Revistën “CONSTITUTIO”, nr. 1/12, prill 2012, botim i Institutit për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare, Prishtinë, Republika e Kosovës;
- 6) “Aspekte aktuale të pushtetit gjyqësor në Shqipëri dhe të perspektivës integruese” - Botuar në Revistën “Gjeopolitika”, nr. VIII, 2012, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, Tiranë;
- 7) “Organizimi gjyqësor sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës” - Botuar në revistën “Gjeopolitika”, nr. IV, viti 2010;
- 8) “Kushtetuta e Republikës së Kosovës në një vështrim krahasues”, parashtrim i librit të Prof. Luan Omarit - Botuar në Revistën “Gjeopolitika”, nr. IV, viti 2010, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, Tiranë;
- 9) “Reforma gjyqësore në Shqipëri” - Botuar në “Sigma”, botim i Bashkimit Evropian, Bruksel, shkurt 2005/ website:
<http://www.sigmaxweb.org/publicationsdocuments/34857721.pdf>
- 10) “Aspekte të organizimit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” - Referuar në Konferencën Rajonale për punën e Sistemit gjyqësor, Prishtinë, Republika e Kosovës, prill 2003;
- 11) “Gjykimet e posaçme” - Botuar në Revistën “Trajtime Juridike”, botim i Fondacionit “Danida”, Tiranë 2002;
- 12) “Aspekte të reformës në drejtësi” - Botuar në Revistën “Klinika”, botim i Fondacionit “Klinika e Ligjit”, Tiranë, 2002;

13) “Teknikat hetimore në krimet e vrasjes dhe veprimet e subjekteve procedural të ndjekjes penale gjatë hetimit të tyre” - Botuar në Revistën Shkencore të Shkollës së Magjistraturës, “Jeta juridike”, nr.1, Qershor 2002, Rubrika “Artikuj teorike”;

14) “Krimi dhe drejtësia, përballja me ndryshimet në shekullin e XXI” - Referuar në Kongresin e 10-të të Kombeve të Bashkuara “Për parandalimin e krimeve dhe trajtimin e viktimave”, prill 2000, Vjenë, Austri, website:

https://www.unodc.org/documents/congress//Previous_Congresses/10th_Congress_2000/038_ACONF.187.MISC.1_Provisional_List_of_Participants.pdf;

15) “Çështja e dënimit me vdekje” - Botuar në Revistën Shkencore të Departamentit të Shkencave Juridike, të Universitetit të Triestes, Itali, “Quaderni del Dipartimento di Scienze Giuridiche”, nr. 4, viti 1999, fq. 191-195.

26. Së fundi, gjatë procedurës së përzgjedhjes u administruan edhe disa dokumente të përgatituar në kuadër të projekteve apo grupeve të punës të finalizuara me botime, e më konkretisht:

1) Dokumente të Kuvendit të Shqipërisë për Reformën në Sistemin e Drejtësisë (Përfaqësues i Komisionit Këshillimor të Reformës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë, Bashkëdrejtues i Grupit për Financimin e Drejtësisë, Ekspert i Nivelit të Lartë në Grupin për Reformën në Sistemin Gjyqësor dhe në Grupin për Institucionet e Shërbimeve Ligjore);

2) “Reforma në Sistemin e Drejtësisë. Analiza dhe Strategjia”, Vëllimi I, Pjesa e Parë - Bordi Editorial (Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë);

3) “Hyrje në edukimin ligjor” - Udhëzues për të rinjtë, Tiranë, shtator 2011 - Botim i Institutit Kërkimor-Shkencor “Barleti” dhe i Universitetit Marin Barleti;

4) “Raport monitorimi 2011 për kujdesin ndaj shëndetit mendor në sistemin e burgjeve në Shqipëri” - Botim i Institutit Europian të Tiranës;

5) “Raport monitorimi mbi zbatimin e masterplanit “Sistemi shqiptar i paraburgimit (2005-2008). Situata aktuale dhe sfidat” - Botim i Institutit Europian të Tiranës;

6) “Këshilli i Lartë i Drejtësisë” - Botim për organizimin dhe veprimtarinë e institucionit;

7) Buletini ligjor “Të drejtat e njeriut në Europë”, mbi jurisprudencën e vendimeve të Gjykatës për të Drejtat e Njeriut. Qendra Europiane Tiranë.

27. Përveç sa sipër, gjatë procedurës së përzgjedhjes, kandidati u ftua të bëjë edhe një vetëvlerësim, kjo pasi, sa i përkiste vlerësimit të treguesit “Origjinaliteti dhe/ose impaktit”, nevojiteshin të dhëna konkrete të referuara nga kandidati, mbi të cilat Këshilli do të mund të identifikonte dhe të orientohej për origjinalitetin dhe/ose impaktin e pesë dokumenteve profesionale të përzgjedhur në kuadër të procesit të vlerësimit dhe pikëzimit. Gjithashtu, vetëvlerësimi, ndërsa duhej të fokusohej në treguesit e përcaktuar sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, do të shërbente edhe

për një vlerësim të drejtë edhe për treguesit e tjerë të kriterit “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”.

28. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Origjinaliteti dhe/ose Impakti”:

28.1 Për indikatorin “Origjinaliteti dhe/ose Impakti”, pasi shqyrtoi përmbajtjen e dokumenteve si më lart, si dhe vetëvlerësimin e kandidatit, Këshilli vlerësoi se ato përbëjnë punë origjinale të autorit.

28.2 Në kuadër të vlerësimit të pesë dokumenteve ligjore mbi të cilat kandidati kërkoi që të vlerësohej: dy dokumentet e para kanë të bëjnë me drejtësinë penale për të mitur, që në kuadër të Reformës në Drejtësi mori një vëmendje të veçantë dhe u finalizua me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur; dy dokumentet e tjerë kanë të bëjnë me analizën e punës së një magjistrati dhe të një gjyqtari për botimin mbi “Koment i Procedurës Penale”, botime që përbëjnë vlerë të shtuar në doktrinën juridike pasi vetë puna analizuese që ka bërë kandidati mbi këto dy punime, çon më tej mendimin juridik dhe identifikon risitë që sjellin këto punime e botime; ndërkohë, dokumenti i fundit përbën aktin themelor të një institucioni të arsimit të lartë, i cili është finalizuar me miratimin e tij nga organi kompetent dhe rregullon të gjithë veprimtarinë institucionale dhe organizative të këtij institucioni. Këto dokumente përbëjnë punë origjinale, pasi trajtimi i tyre sjell parashtrime, argumente dhe përfundime me interes, ndërkohë që impakti dhe dobishmëria e tyre shtrihet: në ndërmarrjen e nismave ligjore në përmirësimin e situatës për një drejtësi miqësore për fëmijët; në zhvillimin e debatit profesional dhe doktrinar në lidhje me çështjet e trajtuara nga kandidati për magjistrat si dhe nga magjistrati në detyrë; akti i fundit ka impakt mbi dobishmërinë sesi funksionin një institucion i arsimit të lartë.

28.3 Përveç analizës së pesë dokumenteve ligjore të sipërcituara, Këshilli vlerësoi se edhe botimet, punimet dhe artikujt e tjerë shkencorë të punuara dhe botuara nga ana e kandidatit, përbëjnë punë origjinale të tij, duke sjellë risi: në të drejtën sportive; në edukimin ligjor të të rinjve; në doktrinën juridike për të drejtën materiale penale, si dhe atë procedurale; në aspektet institucionale të organit qeverisës së pushtetit gjyqësor, të pasqyruara edhe nga këndvështrimi praktik i tij, në cilësinë e kryetarit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (sot Këshilli i Lartë Gjyqësor). Gjithashtu, Këshilli vlerësoi se kandidati ka punuar edhe manuale trajnimi për punonjësit e Policisë së Shtetit, në lidhje me të drejtat e personave të arrestuar, të ndaluar apo të shoqëruar dhe respektimi i tyre nga Policia e Shtetit, si dhe punë kërkimore, monitoruese dhe rekomanduese, në lidhje me përkujdesin ndaj shëndetit mendor në sistemin e burgjeve në Shqipëri si dhe në lidhje me sistemin shqiptar të paraburgimit, gjendja aktuale e tij dhe sfidat që paraqet. Të gjithë këto botime, punime dhe artikuj shkencore, në vlerësim të Këshillit, pasqyrojnë në fakt punën praktike të kandidatit në fushat respektive, duke dhënë ai kontributin e tij të përfituar gjatë eksperiencës në pozicione të ndryshme pune.

28.4 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Origjinaliteti dhe/ose Impakti”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin z. {...} me 5 pikë.

29. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”:

29.1 Për indikatorin “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”, Këshilli vlerësoi se në pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, sikundër edhe në publikimet shkencore dhe artikujt e tjerë profesional, kandidati shfaq aftësi shumë të mira të mbledhjes dhe analizës së informacionit dhe identifikon zgjidhje me anë të zhvillimit logjik të koncepteve ligjore. Në cilësinë e ekspertit të së drejtës penale e njëkohësisht edhe në rolin e konsulentit profesional në kuadër të projekteve për Drejtësinë Penale për të Miturit, si dhe për financimin e drejtësisë, kandidati ka identifikuar fillimisht objektivat, më tej ka kërkuar, lokalizuar, organizuar dhe përdorur informacione të larmishme për të identifikuar problematikat. Në vijim duke bërë analizat përkatëse, në zbatim të standarteve europiane dhe ndërkombëtare, ka dhënë edhe sugjerimet përkatëse për të gjithë masat që duhet të ndërmerren si në kuadrin ligjor, ashtu edhe atë praktik. Në dokumentet e tjerë që përbëjnë projektligje, si në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, Statutin e Universitetit Privat, aktet e Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë apo pasur parasysh cilësinë e tij si Ekspert i Nivelit të Lartë në kuadër të Reformës në Drejtësi, kandidati ka treguar aftësi shumë të mira të hartimit të projektligjeve, duke identifikuar, arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore në funksion të qëllimit për të cilin hartohet akti, duke shpallur aftësi të larta të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, si dhe të teknikës legjislativë. Eksperti ose zyrtari i cili ngarkohet me procesin e përpilimit të politikave dhe hartimit të legjislacionit, duhet të njoh rregullat dhe procedurat e hartimit të legjislacionit, duke kuptuar drejt qëllimin për të cilin hartohet një akt, për rrjedhojë procesi i hartimit kërkon aftësi shumë të mirë analizuese dhe hulumtuese, duke identifikuar paraprakisht problematikat dhe rregullimet që duhen parashikuar me qëllim që akti të arrijë qëllimin për të cilin hartohet si dhe zbatueshmërinë e tij në praktikë. Të gjitha këto cilësi analitike dhe hulumtuese të kandidatit janë evidentuar edhe në opinionet vlerësuese të përcjella nga institucionet ku ka punuar kandidati. Duke vlerësuar në tërësi të gjithë punimet e paraqitura nga kandidati, botime, artikuj dhe punime shkencore, ai tregon nivel të lartë të arsyetimit dhe zbatimit të koncepteve ligjore, ofron argumente në lidhje me zbatimin e parimeve dhe parashikimeve ligjore, identifikon në mënyrë të harmonizuar burimet e ndryshme të së drejtës dhe trajton çështje e problematikave në varësi të tematikës që trajtohet apo qëllimit që ka secili dokument, duke identifikuar praktikën gjyqësore vendase dhe atë ndërkombëtare, si dhe të dhënat relevante.

29.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Aftësitë analitike dhe hulumtuese”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin {...} me 5 pikë.

30. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”:

30.1 Për indikatorin “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”, Këshilli vlerësoi se në pesë dokumentet profesionale, si edhe në botimet dhe artikujt e tjerë shkencorë, kandidati ka bërë paraprakisht një përcaktim të qartë të problemit, ka zhvilluar në mënyrë logjike konceptet juridike, ka përdorur në mënyrë korrekte dhe konsistente termat teknike. Po ashtu, kandidati ka përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe të drejtëpërdrejtë që mbërrin edhe tek publiku i gjerë, përveç se ai ka respektuar edhe rregullat gramatikore dhe të sintaksës. Gjithashtu, gjuha, paragrafët dhe struktura e fjalisë në këto dokumente, janë përzgjedhur nga kandidati në mënyrë të kudjesshme dhe i gjithë dokumenti ka vijueshmëri logjike.

30.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin {...} me 5 pikë.

31. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Interpretimi i harmonizuar”:

31.1 Për indikatorin “Interpretimi i harmonizuar”, Këshilli vlerësoi se në pesë dokumentet profesionale, si edhe në botimet dhe artikujt e tjerë shkencorë, kandidati identifikon dhe interpreton në mënyrë të harmonizuar burimet e ndryshme të së drejtës, si dhe tregon dhe argumenton ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e problemit. Në varësi të llojit të dokumentit, tentikës së trajtuar dhe qëllimit për të cilin është hartuar secili dokument, rezultoi se kandidati interpreton në përputhje me njëra-tjetrën parimet e së drejtës, burimet e së drejtës ndërkombëtare dhe asaj kombëtare, si dhe arsyeton zbatimin e ligjit në rastin konkret. Kjo është një cilësi shumë e rëndësishme për një gjyqtar të Gjykatës së Lartë, sidomos në kuadër të njësimin, ndryshimit apo të zhvillimit të praktikës së Gjykatës së Lartë, ku nëpërmjet praktikës së saj gjyqësor ajo duhet të vendosë legjitimitet në lidhje me sigurinë juridike.

31.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Interpretimi i harmonizuar”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin {...} me 5 pikë.

32. Vlerësimi dhe pikëzimi për indikatorin “Referencat e praktikës gjyqësore”:

32.1 Për indikatorin “Referencat e praktikës gjyqësore”, Këshilli vlerësoi se në botimet, punimet dhe artikujt e tjerë shkencorë, si dhe referimeve të tij në konferenca shkencore (pasi pesë dokumentet e shqyrtuara për vlerësim janë të një natyre tjetër e nuk kanë referime të praktikës gjyqësore), kandidati trajton dhe referon me efektivitet, në vendin e duhur e sipas llojit dhe qëllimit të aktit, praktikën e konsoliduar gjyqësore, praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë, praktikën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe praktikën e gjykatave ndërkombëtare etj.

32.2 Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës së dokumentacionit të administruar, në lidhje me treguesin “Referencat e praktikës gjyqësore”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin {...} me 5 pikë.

33. Përfundimisht, sa më sipër, për kriterin e vlerësimit “Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 25 pikë në total.

34. Kriteri i tretë i Kategorisë “Meritat profesionale”, është “Kualifikimi Shtesë Profesional”. Ky kriter vlerësimi ndahet në katër nënkritere, e më konkretisht:

- a) “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike”;
- b) “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike”;
- c) “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit”;
- ç) “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”.

35. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike”:

35.1 Neni 49, pika 6, shkronja “a”, i Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimi 102/2019 dalë në zbatim të ligjit, përcaktojnë si nënkriter për vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve edhe *ekspertizën e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë*. Ky përcaktim ligjor, vjen në përputhje me përcaktimet që ka bërë Ligji nr. 98/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 31, pika 1 dhe pika 3, që parashikojnë se: “1. Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ. ... 3. Kolegji Penal shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar për çështje penale, si dhe çështje të tjera të caktuara në kompetencë me ligj. ...”.

35.2 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, në mënyrë ideale, Gjykata e Lartë përbëhet nga anëtarë me ekspertizë në fusha të ndryshme të së drejtës, me një veprimtari të njohur profesionale. Fushat e ndryshme të ekspertizës plotësojnë njëra-tjetrën për të pasuruar dhe zgjeruar fushën e aktiviteteve të mbuluara nga Gjykata e Lartë. Për këtë arsye, ky kriter vlerësimi dhe pikëzimi i Kategorisë “Meritat profesionale”, synon të vlerësojë rëndësinë dhe dobinë e specializimit të arritur në përvojën e veçantë profesionale të kandidatit, në mënyrë që të sigurojë “plotësimin e ekspertizës” profesionale dhe të pasurojë kapacitetet profesionale të Gjykatës së Lartë me profesionistë të spikatur, ndër të tjerë, edhe nga fusha e të drejtës penale. Vlerësimi i kandidatëve referuar kohëzgjatjes së angazhimit të posaçëm ose të profilizuar në fushën konkrete të së drejtës, bëhet në mënyrë të përshkallëzuar, duke marrë parasysh edhe llojshmërinë e angazhimit në fushën specifike, si lektor i së drejtës, avokat, gjyqtar, këshilltar etj. Ky nënkriter

vlerësohet deri në 6 pikë në rastin kur kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike është mbi 15 vjet.

35.3 Kandidati z. {...} ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale e për pasojë, kohëzgjatja e angazhimit të tij në fushën specifike vlerësohet pikërisht në këtë fushë të së drejtës.

35.4 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar, rezultoi se kandidati {...}, deri në momentin e kandidimit, ka një përvojë të gjatë profesionale në fushën e të drejtës penale, përmbi 15 vjet (20 vjet e 7 muaj). Konkretisht, kandidati ka angazhimin në fushën e të drejtës penale: si lektor i së drejtës penale (me kohë të plotë) për një kohëzgjatje prej 11 vjet e 11 muaj; si specialist i lartë në administratën publike (në sektorin e hetimit të veprave penale) për një kohëzgjatje prej 5 vjet e 2 muaj e 15 ditë; dhe si avokat për një kohëzgjatje prej 3 vjet e 5 muaj e 15 ditë. Përveç angazhimit me kohë të plotë në fushën e të drejtës penale, kandidati ka edhe angazhime të tjera, me kohë të pjesshme, në këtë fushë, si ekspert, përshëmbull: në përgatitjen e “Dokumentit Strategjik për një Drejtësi Miqësore për Fëmijët” (15 ditë pune - referuar termave të referencës për Konsulentin e të Drejtës Penale); në përgatitjen e Projektit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (7 muaj - referuar Vlerësimin të Produktit për Konsulentë dhe Kontraktorë Individualë UNICEF); si dhe ekspertiza të tjera përgjatë viteve si dhe ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës (kohëzgjatja e paërcaktuar, referuar shkresës nr.701 prot., datë 15.08.2019, të Shkollës së Magjistraturës).

35.5 Megjithatë, vlen të përmendet se angazhimi i kandidatit në fushën e të drejtës rezulton të mos ketë qenë vetëm si i punësuar, por ai ka treguar një angazhim përtej të zankonshmes ndaj të drejtës penale dhe asaj institucionale. Kandidati rezulton të jetë angazhuar në vijimësi për të thelluar njohuritë e tij në fushën e së drejtës penale, duke bërë trajnime të ndryshme jashtë shtetit, specializime, si dhe studime pasuniversitare. Ai ka treguar interes të vazhdueshëm edhe për ndryshimet institucionale në fushën që i përket qeverisjes së sistemit të drejtësisë, kjo edhe për shkak të qenies së tij Zëvendëskryetar i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që në mënyrë indirekte ka afektuar edhe administrimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri. Në këtë kuadër, këto të dhëna tregojnë se ai ka një angazhim edhe ndaj çështjes së administrimit të Gjykatës së Lartë në të ardhmen. Angazhimi i kandidatit është ngritur edhe në nivel më të lartë, duke u caktuar shpeshherë si konsulent, ekspert i së drejtës, në lidhje me projekte të ndryshme, të ndërmarra edhe nga organizata ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, përfshirë këtu UNICEF Albania, Fondacioni “Save the Children”, Zyra e Këshillit të Europës në Shqipëri etj, në lidhje me fushën e zbatimit të së drejtës. Angazhimi dhe përkushtimi i kandidatit ka qenë real, i prekshëm dhe frutdhënës, pasi njohuritë e tij mbi të drejtën penale dhe atë institucionale nuk ka ngruruar t’ua shpalosë edhe të tjerëve, sidomos në kuadër të reformave të ndryshme në Shqipëri, kulmuar me Reformën e fundit në Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri. Gjithashtu, referuar të dhënave të administruara, duke filluar nga mesi i vitit 2019, kandidati rezulton të jetë i kontraktuar si ekspert i UNICEF-it, në mbështetje

të Ministrisë Drejtësisë dhe të institucioneve të tjera shtetërore, për vënien në zbatim të kuadrit normative të drejtësisë për të mitur.

35.6 Ndaj nga sa më lart, për nënkriterin e vlerësimit “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike”, pasur parasysh kohëzgjatjen e angazhimit në fushën specifike (të së drejtës penale), si dhe shumëllojshmërinë e angazhimeve në këtë fushë, Këshilli çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 6 pikë.

36. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Botime relevante dhe ndikimi i rezultate profesionale në fushën specifike”:

36.1 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, Këshilli cakton deri në 2 pikë për botime relevante në fushën specifike, të tilla si monografi, artikuj në revista shkencore, raporte, udhëzues, komentare etj. Këshilli merr parasysh numrin e botimeve si edhe ndikimin e rezultateve profesionale në atë fushë, si për shembull përdorimin si pjesë e programeve të studimit, në praktikën e institucioneve, si referencë në punimet e autorëve të tjerë. Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë nëse botimet relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale të kandidatit në fushën specifike janë realizuar në vendet e BE/OECD. Gjithashtu, Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë për impaktin e botimeve relevante të kandidatit në zhvillimin e doktrinës dhe të jurisprudencës gjyqësore në këtë fushë.

36.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi që kandidati z. {...} të ketë punuar një sërë botimesh, monografi, artikuj shkencorë, udhëzues në fushën e së drejtës penale, publikuar në Shqipëri, por edhe jashtë saj, e për këtë u administruan:

- 1) Procedura Penale - Komentar (Criminal Procedure - Commentary) - Botim në gjuhën shqipe dhe angleze (Bashkëautorësi me {...} dhe {...});
- 2) “Organizimi Gjyqësor në lëndën penale në Republikën e Shqipërisë” - Libër monografik;
- 3) “Të drejtat e personave të arrestuar, të ndaluar apo të shoqëruar dhe respektimi i tyre nga Policia e Shtetit” - Manual;
- 4) “Raport mbi Studimin e Përqsjes së Legjislacionit Shqiptar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”;
- 5) “Rruga e “gjatë” dhe e “mundimshme” e vendimit nga shpallja deri në dorëzimin e tij” - Botuar në Revistën “Jeta Juridike” nr. 1, Mars 2015, botim i Shkollës së Magjistraturës, Tiranë. (The “long” and “difficult” way of the decision from notification up to handling (Botuar edhe në gjuhën angleze);
- 6) “Aspekte të jurisprudencës kushtetuese për çështjen e pakicave” - Botuar në Revistën Gjeopolitika”, nr. VIII, 2013, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, Tiranë;

- 7) “Vendi dhe roli i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që nga Kushtetuta e vitit 1998. Përgjegjësia për të ndërtuar një gjyqësor të përgjegjshëm e të pavarur” - Botuar në Revistën “Mendimi” (Studime në Jurisprudencë dhe Ekonomi) nr. 1, 2013;
- 8) “Aspekte aktuale të pushtetit gjyqësor në Shqipëri dhe të perspektivës integruese” - Botuar në Revistën “Gjeopolitika”, nr. VIII, 2012, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, Tiranë;
- 9) “Roli dhe pozita e Presidentit të Republikës së Shqipërisë në drejtimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” - Botuar në Revistën “CONSTITUTIO” nr. 1/12, prill 2012, botim i Institutit për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare, Prishtinë, Republika e Kosovës;
- 10) “Aspekte aktuale të pushtetit gjyqësor në Shqipëri dhe të perspektivës integruese” - Botuar në Revistën “Gjeopolitika”, nr. VIII, 2012, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, Tiranë;
- 11) “Organizimi gjyqësor sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës” - Botuar në revistën “Gjeopolitika”, nr. IV, 2010;
- 12) “Kushtetuta e Republikës së Kosovës në një vështrim krahasues” - Parashtrim i Librit të Prof. {...}- Botuar në Revistën “Gjeopolitika”, nr. IV, 2010, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, Tiranë;
- 13) “Reforma gjyqësore në Shqipëri” - Botuar në “Sigma”, botim i Bashkimit Evropian, Bruksel, shkurt 2005;
- 14) “Aspekte të organizimit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” - Referim në Konferencën Rajonale për punën e Sistemit gjyqësor, Prishtinë, Republika e Kosovës, prill 2003;
- 15) “Gjykimet e posaçme” - Botuar në Revistën “Trajtime Juridike”, botim i Fondacionit “Danida”, Tiranë 2002;
- 16) “Aspekte të reformës në drejtësi” - Botuar në Revistën “Klinika”, botim i Fondacionit “Klinika e Ligjit”, Tiranë, 2002;
- 17) “Teknikat hetimore në krimet e vrasjes dhe veprimet e subjekteve procedural të ndjekjes penale gjatë hetimit të tyre” - Botuar në Revistën Shkencore të Shkollës së Magjistraturës, “Jeta juridike”, nr. 1, Qershor 2002, Rubrika “Artikuj teorike”.

36.3 Nga dokumentet e administruara, rezultoi se kandidati ka një numër të konsiderueshëm botimesh, artikuj, punime shkencore, monografi, udhëzues në fushën specifike të së drejtës penale dhe konkretisht në lidhje me: të drejtat e personave që janë nën masa sigurimi; drejtësinë penale për të mitur; të drejtën procedurale penale; aspektet institucionale që i përkasin qeverisjes së pushtetit gjyqësor si dhe organizimit gjyqësor në fushën penale. Me rëndësi për vlerësimin në rastin konkret është libri në bashkëautorësi i autorit “Komentari i Procedurës Penale”, i cili përbën botimin bazë në kurrikulat universitare në lidhje me drejtësinë, si dhe në Shkollën e Magjistraturës. Ky botim rezultoi të jetë përkthyer edhe në gjuhën angleze, duke bërë që ndikimi i tij të rezultojë

edhe jashtë kufijve të shtetit shqiptar e mund të përdoret edhe nga studentët e huaj të së drejtës, apo dhe nga praktikuesit e të drejtës.

36.4 Kandidati rezulton të ketë edhe botime relevante në vendet e BE/OECD e më konkretisht botimi në revistën shkencore juridike të Universitetit të Triestes, Itali, “Aspekte të dënimit me vdekje”, ku botimi për kohën ka pasur rëndësinë e vet, në kuadër të zotimit që ndërmori shteti shqiptar për shfuqizimin e dënimit me vdekje, për debatet pro dhe kundër që ka pasur në lidhje me të, si dhe për prespektivën e Shqipërisë në kuadër të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, bazuar në përcaktimet kushtetuese, sipas Kushtetutës së vitit 1998 dhe standarteve të vendosura nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu, edhe referimi i bërë nga kandidati në Kongresin e 10 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në lidhje me temën “Parandalimi i krimit dhe trajtimi i shkelësve. Krimi dhe drejtësia: përmbushja e sfidave të Shekullit të Njëzet e Një”, përbën një referim me vlerë.

36.5 Ndaj nga sa më lart, për nënkriterin e vlerësimit “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike”, duke patur parasysh numrin e botimeve të kandidatit në fushën specifike, si dhe ndikimin e tyre në Shqipëri e më gjerë, Këshilli çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 6 pikë.

37. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit”:

37.1 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, Këshilli cakton deri në 4 pikë për konsulencat në fushën përkatëse të së drejtës si edhe për kontributet në hartimin e legjislacionit, bazuar në të dhëna të dokumentuara. Këshilli vlerëson rolin, sasinë dhe cilësinë e angazhimit, dhe ndikimin në veprimtarinë specifike. Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë për shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit duke vlerësuar nëse konsulenca në fushën përkatëse të ligjit është realizuar në vendet e BE/OECD.

37.2 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka qenë konsulent dhe ka kontribut real në hartimin e legjislacionit dhe për këtë u administruan:

- 1) “Dokument strategjik mbi Drejtësinë Miqësore për të Mitur” - UNICEF - Për të informuar dhe sugjeruar procesin e përgatitjes së Strategjisë së Reformës së Sistemit të Drejtësisë për Drejtësinë Penale dhe për Financimin e Sistemit të Drejtësisë;
- 2) “Projekt i Kapitujve V-VII të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur” - UNICEF - Në kuadër të përgatitjes së projektit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pjesë e kuadrit të reformës në Sistemin e Drejtësisë;
- 3) “Reforma në sistemin e drejtësisë”, Vëllimi I, Pjesa e parë, botim i Kuvendit të Shqipërisë;

4) Statut i Universitetit “Marin Barleti”-Projekt;

5) “Projektvendime” - Për Bordin e Akreditimit pranë Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

37.3 Sipas dokumenteve të administruara, kandidati ka dhënë konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit penal shqiptar; në përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të standarteve të KEDNJ-së; në hartimin e Kodit të Drejtësisë për të Miturit; të statutit (aktin themelor) të një institucioni të arsimit të lartë; të akteve rregullatore të Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Përveç kësaj, vlen për t’u mbajtur parasysh edhe roli, sasia dhe cilësia e angazhimit të kandidatit, si dhe ndikimi në veprimtarinë specifike. Rezulton që roli i kandidatit të ketë qenë shumë i rëndësishëm, ku angazhimi i tij ka qenë jo vetëm në kuadër të konsultave për institucionet shqiptare por edhe në kuadër të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, si UNICEF Albania, Zyra e Këshillit të Europës. Po ashtu, vlen për t’u mbajtur në konsideratë edhe angazhimi i kandidatit në kuadër të Reformës në Drejtësi, në të cilën ai ka patur cilësinë e ekspertit të nivelit të lartë, ndërsa është angazhuar si bashkëdrejtues i grupit të punës “Për financimin e sistemit të drejtësisë”. Vlen për t’u mbajtur në konsideratë gjithashtu edhe fakti se kandidati është kontraktuar nga UNICEF, jo vetëm në kuadër të hartimit të akteve ligjore për drejtësinë penale për të mitur, por edhe në vijim, në lidhje me zbatimin në praktikë të legjislacionit në këtë fushë. Krahas sa më lart, evidentohet se kontributet e kandidatit në hartimin e legjislacionit janë domethënëse, pasi konsulencat dhe punimet e tij në kuadër të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë finalizuar edhe me miratimin dhe hyrjen në fuqi të këtij Kodi, i pari i këtij lloji në legjislacionin shqiptar, sikundër edhe me miratimin e kuadrit tjetër ligjor apo nënligjor, në varësi të përfshirjes në institucione të ndryshme kontraktuese.

37.4 Ndaj nga sa më lart, për nënkriterin e vlerësimit “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit”, duke qenë se kandidati ka një sërë kontributesh në hartimin e legjislacionit, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 4 pikë.

38. Vlerësimi dhe pikëzimi për nënkriterin “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”:

38.1 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit ky nënkriter është zbërthyer në tre tregues, e konkretisht:

- i) “Pjesëmarrje në konferenca shkencore”;
- ii) “Mësimdhënie”
- iii) “Çmime dhe tituj”.

38.2 Sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, Këshilli vlerëson në veçanti edhe referimet në konferenca shkencore kombëtare, në fushën specifike të specializimit, bazuar në fjalimet e

dorëzuar, dhe cakton deri në 2 pikë, duke marrë parasysh numrin e referimeve dhe rolin e referuesit. Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë nëse referimet në fushën specifike - të dokumentuara nga fjalimet e dorëzuar nga kandidati - janë realizuar në konferenca shkencore ndërkombëtare në vendet e BE/OECD, duke marrë parasysh numrin e referimeve dhe rolin e referuesit. Këshilli vlerëson edhe përvojën e mësimdhënies, në fushën specifike të specializimit, për profesionistët (për shembull gjyqtarët, prokurorët, avokatët etj.), dhe duke marrë parasysh numrin e angazhimeve, kohëzgjatjen, institucionin, rolin si mësimdhënës/trajnes, cakton deri në 4 pikë. Për përvojën si pedagog, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme ose si "profesor vizitor/personel akademik i ftuar", në fushën specifike të specializimit, në vendet e BE/OECD, Këshilli cakton deri në 2 pikë. Kandidatit i caktohen gjithashtu deri në 2 pikë për çmime ose tituj të veçantë nderi në vendet e BE/OECD.

38.3 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Pjesëmarrje në konferenca shkencore”:

38.3.1 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka një sërë pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit, provuar këto me referimet përkatëse, ku për këtë u administruan:

- 1) “Aspekte të jurisprudencës kushtetuese për çështjen e pakicave” - Botuar në Revistën Gjeopolitika”, nr. VIII, 2013, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, Tiranë;
- 2) “Vendi dhe roli i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që nga Kushtetuta e vitit 1998. Përgjegjësia për të ndërtuar një gjyqësor të përgjegjshëm e të pavarur” - Botuar në Revistën “Mendimi” (Studime në Jurisprudencë dhe Ekonomi) nr. 1, 2013;
- 3) “Aspekte aktuale të pushtetit gjyqësor në Shqipëri dhe të perspektivës integruese” - Botuar në Revistën “Gjeopolitika”, nr. VIII, 2012, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, Tiranë;
- 4) “Roli dhe pozita e Presidentit të Republikës së Shqipërisë në drejtimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” - Botuar në Revistën “CONSTITUTIO” nr. 1/12, prill 2012, botim i Institutit për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare, Prishtinë, Republika e Kosovës;
- 5) “Aspekte aktuale të pushtetit gjyqësor në Shqipëri dhe të perspektivës integruese” - Botuar në Revistën “Gjeopolitika”, nr. VIII, 2012, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, Tiranë;
- 6) “Organizimi gjyqësor sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës” - Botuar në revistën “Gjeopolitika”, nr. IV, 2010;
- 7) “Kushtetuta e Republikës së Kosovës në një vështrim krahasues”, parashtrim i Librit të Prof. {...} - Botuar në Revistën “Gjeopolitika”, nr. IV, 2010, botim i Institutit Kërkimor Shkencor “Barleti”, Tiranë;
- 8) “Krimi dhe drejtësia, përballja me ndryshimet në shekullin e XXI”, referim i mbajtur në Kongresin e 10-të të Kombeve të Bashkuara “Për parandalimin e krimeve dhe trajtimin e

viktimave”, prill 2000, Vjenë, Austri. Pjesëmarrja vërtetohet edhe nëpërmjet aksesit të faqes së internetit:

https://www.unodc.org/documents/congress//Previous_Congresses/10th_Congress_2000/038_ACONF.187.MISC.1_Provisional_List_of_Participants.pdf

9) “Çështja e dënimit me vdekje”. Botuar në Revistën Shkencore të Departamentit të Shkencave Juridike, të Universitetit të Triestes, “Quaderni del Dipartimento di Scienze Giuridiche”, nr. 4, viti 1999, fq. 191-195.

38.3.2 Sipas dokumenteve të administruara, kandidati z. {...} ka pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, të zhvilluar në Shqipëri, në Kosovë, si dhe në vendet e BE-së, konkretisht Itali dhe Austri. Këto pjesëmarrje të kandidatit, provohen me referimet që ai ka bërë, të cilët janë publikuar në revista të ndryshme juridike, ku rezulton se referimet e kandidatit janë në fushën e të drejtës penale, në të drejtën institucionale, apo edhe në këndvështrim të çështjeve që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare, apo edhe të së drejtës së krahësuar, duke vlerësuar këtu këndvështrimet që ai sjell në lidhje me Kushtetutën dhe organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Kosovës.

38.3.3 Ndaj nga sa më lart, për treguesin “Pjesëmarrje në konferenca shkencore”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 4 pikë.

38.4 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Mësimdhënie”:

38.4.1 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka përvojë të gjatë në mësimdhënie për profesionistët e së drejtës, provuar kjo me referimet përkatëse ose dokumentacion tjetër provues, kryesisht në Shkollën e Magjistraturës dhe për këtë u administruan:

1) Shkresa nr. 701/1 prot., datë 15.08.2019, e Shkollës së Magjistraturës, përmes së cilës konfirmohet fakti se kandidati:

- ka qenë pedagog i brendshëm në Programin e Formimit Fillestar gjatë periudhës 1997 - 1999 dhe më pas pedagog i jashtëm për periudhën 1999 - 2007 dhe 2015 e në vazhdim;
- si dhe ekspert në Programin e Formimit Vazhdues nga viti 2012 e në vazhdim;

2) Shkresa nr. 907/1 prot., datë 12.12.2019, e Shkollës së Magjistraturës, përmes të cilës konfirmohet faktin se kandidati është pedagog i jashtëm në këtë Shkollë, për lëndën “Procedurë Penale”, e cila trajtohet gjatë vitit të parë teorik në Programin e Formimit Fillestar për Magjistrat.

38.4.2 Sipas dokumenteve të administruara, kandidati z. {...} ka përvojë të gjatë në mësimdhënie, si për studentët e së drejtës, ashtu edhe për profesionistët, pranë Shkollës së Magjistraturës, e cila përgatit kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm, e vitet e fundit edhe për këshilltarët e

ndihmësit ligjorë. Kandidati është pedagog i jashtëm pranë Shkollës së Magjistraturës për studentët për në Formimin Fillestar, si dhe në cilësinë e ekspertit, ku trajnon profesionistët e së drejtës, magjistratët në kuadër të Formimit Vazhdues. Ky fakt u evidentua nga kandidati edhe gjatë intervistës përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nga dokumentacioni i administruar për kandidatin nuk rezultoi ndonjë përvojë si pedagog me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme ose si “profesor vizitor/personel akademik i ftuar” në fushën e të drejtës penale, në vendet e BE/OECD.

38.4.3 Ndaj nga sa më lart, për treguesin “Mësimdhënie”, duke patur parasysh kohëzgjatjen, institucionin, rolin si mësimdhënës/trajnuës të kandidatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se ai duhet të vlerësohet me 4 pikë.

38.5 Vlerësimi dhe pikëzimi për treguesin “Çmime dhe tituj”:

38.5.1 Nga dokumentacioni i administruar për kandidatin, nuk rezultoi që ai të ketë çmime ose tituj të veçantë nderi në vendet e BE/OECD.

38.5.2 Ndaj nga sa më lart, për treguesin “Çmime dhe tituj”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 0 pikë.

38.6 Për rrjedhojë, për nënkriterin e vlerësimit “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 8 pikë në total.

39. Përfundimisht, sa më sipër, për kriterin e vlerësimit “Kualifikimi shtesë profesional”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi ta vlerësojë kandidatin me 24 pikë në total.

40. Kategoria e dytë e vlerësimit është “Meritat morale dhe etike”. Kjo kategori vlerësimi ndahet në tre kriterë, e më konkretisht:

- 1) “Shmangia e shfaqjes së pahijshme”;
- 2) “Nderi dhe dinjiteti”;
- 3) “Reputacioni”.

41. Neni 136, pika 3, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton se: “3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur...”. Nga interpretimi i dispozitave kushtetuese, por dhe i atyre të ligjit të posaçëm, lex specialis, rezulton se ligji material ka përçuar qëllimin e Kushtetutbërësit për transformimin e Gjykatës së Lartë “në një gjykatë karriere” përmes vendosjes së kriterëve transparente për emërimin e gjyqtarëve nga të dy kategoritë (gjyqtarë dhe jogjyqtarë/juristë të spikatur)”, për të garantuar një përbërje cilësore jo

vetëm nga pikpamja profesionale, por mbi të gjitha edhe të integritetit të figurës. Për pasojë, përmes kuadrit rregullator në tërësi, nëpërmjet kritereve të vendosura, është synuar identifikimi i juristëve të aftë profesionalisht dhe me integritet të lartë moral, pasi në suksesin e vërtetë të një Gjykate të Lartë ndikojnë sa dijet ligjore të gjyqtarëve, aftësia e tyre për të ushtruar që në fillim disiplinë doktrinare, por po aq të rëndësishme janë edhe cilësitë dhe integriteti tyre, në mënyrë që të kontribuojnë në pavarësinë e gjykatës, për ta bërë atë të pathyeshme ndaj çdo lloj sulmi apo fenomeni negativ që e cënojnë atë.

42. Sipas Vendimit 102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kategori bazohet në atë nëse kandidati miraton, respekton dhe mbështet vlerat themelore të punës së pritshme të gjyqtarit, siç janë (1) shmangja e shfaqjes së pahijshme, (2) nderi dhe dinjiteti, dhe (3) reputacioni, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë. Kandidati duhet të jetë i vetëdijshëm se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut. Vlerësimi dhe pikëzimi i kësaj kategorie vlerësimi, sipas kritereve më sipër, bëhet sipas një rendi zbritës, duke supozuar se kandidati ka integritet etik dhe moral të plotë. Mbi këtë qasje, kandidati e fillon procedurën e vlerësimit me totalin e pikëve referuar secilit kriter të kësaj kategorie vlerësimi, dhe nëse burime të provuara dhe të besueshme evidentojnë një mangësi në lidhje me integritetin moral dhe etik, Këshilli cakton për kandidatin minimumin e pikëve (1 pikë). Të dhënat për vlerësim dhe pikëzim të kandidatit janë ato që rezultojnë nga gjetjet në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit apo nga informacione të tjera të verifikuara nga Këshilli.

43. Për kandidatin z. {...}, gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, nuk rezultoi asnjë gjetje negative në raport me figurën, referuar treguesve respektivë për secilin kriter të kësaj kategorie vlerësimi. Po ashtu, për kandidatin, gjatë gjithë procesit të kandidimit nuk rezultoi ndonjë informacion tjetër negativ në lidhje me figurën, referuar treguesve respektivë për secilin kriter të kësaj kategorie vlerësimi.

44. Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} të jetë person që gëzon integritet dhe moral të plotë, ku për këtë u administruan:

- Opinionet Vlerësuese, sipas Shkresës datë 17.07.2019 dhe Shkresës nr.2695 prot., datë 09.08.2019, të Rektorit të Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti”, Prof. Dr. {...};
- Opinion Vlerësues, sipas Shkresës nr. 19/289 HR prot., datë 26.07.2019, të Drejtorit Ekzekutiv të Shoqërisë “Intesa SanPaolo Bank” sh.a, z. {...};
- Opnion Vlerësues, sipas Shkresës datë 28.10.2019, të Kryetarit të Bordit të Akreditimit të Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), Prof. {...} (PhD);

- Shkresa nr. 2153/59 prot., datë 07.10.2019, e Prokurorisë së Përgjithshme, me të cilën është përcjellë Vendimi “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin {...}”, nga rezultoi se ndaj kandidatit nuk është regjistruar ndonjë kallzim, nuk janë kryer referime, nuk ka qenë apo është në hetim për kryerjen e ndonjë vepre penale dhe nuk i është caktuar ndonjë masë shtrënguese e sigurisë personale. Ai nuk figuron i ndaluar/arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e ndonjë vepre penale. Nuk ka të dhëna ose indicie për veprimtari kriminale;
- Shkresa nr. 1118/4 prot., datë 04.09.2019, e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me të cilën është përcjellë Vendimi nr.555, datë 04.09.2019, i këtij Autoriteti, sipas të cilit, nga të gjitha verifikimet e kryera, nuk rezulton që kandidati të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, nuk rezulton të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991;
- Shkresa nr. 5884/1 prot., datë 16.08.2019, e Ministrisë së Drejtësisë, nga rezultoi se kandidati, gjatë marrëdhënies së punës si inspektor dhe më pas specialist në Drejtorinë e Kodifikimit, nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore;
- Shkresa nr. 378/2 prot., datë 13.08.2019, e Dhomës së Avokatisë, nga rezultoi se për kandidatin nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore;
- Shkresa nr. 701/1 prot., datë 15.08.2019, e Shkollës së Magjistraturës, nga rezultoi se kandidati ka qenë pedagog i brendshëm në Programin e Formimit Fillestar për një periudhë, si dhe pedagog i jashtëm për një periudhë tjetër, përveç dhe ekspert në Programin e Formimit Vazhdues, periudha gjatë të cilave ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore;
- Shkresa nr. 2151/1 prot., datë 08.08.2019, e Prokurorisë së Përgjithshme, nga rezultoi se kandidati ka punuar për një periudhë në sistemin e prokurorisë (hetues), gjatë të cilës ndaj tij nuk janë marrë masa disiplinore;
- Të dhëna nga intervistimi i kandidatit, më datë 27.02.2020.

45. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme”:

45.1 Sipas dokumentacionit të administruar, nisur nga të dhënat që rezultuan nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim si anëtar për në Gjykatën e Lartë, intervista me kandidatin, komunikimi i tij gjatë gjithë procedurës së përzgjedhjes, si dhe referuar dokumenteve të tjerë, përfshirë ato të aksesueshme publikisht, si dhe në mungesë të ndonjë të dhënë të ardhur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor gjatë kohës që procedura e përzgjedhjes ishte bërë publike edhe nëpërmjet medias, për kriterin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme”, nuk rezulton që kandidati të ketë treguar mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive. Po ashtu, nuk rezultoi që kandidati: të ketë tejkalime dhe ekstravagancë në ushtrimin e profesionit; të ushtroj apo të ketë ushtruar në të kaluarën profesionin me njëanshmëri; të ketë kërkuar nëpërmjet ndërhyrjes, që të përfitojë një avantazh të pamërituar për veten ose për të tjerët: të ketë pranuar dhurata ose

avantazhe për veten ose për të afërmit, kur ushtron detyrën ose profesionin. Gjithashtu, edhe gjatë intervistës së zhvilluar, kandidati tregoi një sjellje dhe komunikim etik, duke treguar respekt dhe vetëpërmbytje.

45.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Shmangia e shfaqjes së pahijshme”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 5 pikë.

46. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Nderi dhe dinjteti”:

46.1 Sipas dokumentacionit të administruar, si dhe referuar çdo të dhënë tjetër që ka rezultuar për indikatorët si më sipër, në lidhje me kriterin “Nderi dhe dinjteti”, rezultoi që kandidati transmeton vlera personale dhe profesionale, ndërkohë që nuk rezultoi nga burimet e vlerësimit dhe as nga ndonjë e dhënë tjetër, që kandidati të ketë sjellje të tilla që i kundërshtojnë këto të dhëna. Nuk rezultoi ndonjë e dhënë sipas të cilës kandidati: të karakterizohet nga mungesa e vëmendjes dhe interesimit për respektimin dhe dinjtetin e individëve: shpërdoron fondet publike, keqpërdor kohën e punës, personelin dhe burimet për qëllime private: të shfaqë sjellje të bullizmit, frekuentim të dobët në punë apo përdorim të substancave të ndaluara. Përkundrazi, referuar dokumentacionit të administruar, opinioneve vlerësuese të drejtuesve të institucioneve, subjekteve dhe organizatave si më lart, ku kandidati ka marrë pjesë, ai reflekton vlera personale dhe profesionale, është një shembull për kolegët e tij si dhe për studentët, ndërkohë që opionet e dhëna vënë theksion te integriteti i tij, të sjellurit me nder dhe dinjtet.

46.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Nderi dhe dinjteti”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 5 pikë.

47. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Reputacioni”:

47.1 Sipas dokumentacionit të administruar, si dhe referuar çdo të dhënë tjetër që ka rezultuar nga indikatorët si më sipër, në lidhje me kriterin “Reputacioni”, rezultoi që kandidati shfaq arritje mbi nivelin e etikës dhe cilësive morale gjatë përvojës në punë, ndërkohë që nuk rezultoi nga burimet e vlerësimit dhe as nga ndonjë e dhënë tjetër, që kandidati të ketë shfaqur sjellje të tilla që nuk përmbushin pritshmëritë e qytetarëve dhe të shoqërisë në lidhje me cilësitë profesionale të gjyqtarit, të tilla si: rezerva dhe diskrecioni, kujdesi dhe respekti, si dhe cilësitë personale si: mençuria, besnikëria, humanizmi, serioziteti dhe matura. Gjithashtu, Këshilli konsideroi përgjigjen e dhënë nga kandidati në pyetjen e parashtruar nga njëri prej anëtarëve të Këshillit, se cila kishte qenë dilema etike më e madhe me të cilën ai është ndeshur dhe sesi e kishte zgjidhur atë, kandidati parashtroi dy situata, ku ai kishte pasur dilema apo sfida, dhe zgjedhjet që ai kishte bërë ishin përtej interesit të ngushtë personal, por deklaroi se e kishte parë veten si profesionist i së drejtës e për rrjedhojë duhej të jepte kontribut përkatës, sikurse edhe kërkon ta japë edhe tani nëpërmjet kandidimit për në Gjykatën e Lartë.

47.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Reputacioni”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 5 pikë.

48. Kategoria e tretë e vlerësimit është “Meritat organizative dhe menaxheriale”. Kjo kategori vlerësimi ndahet në katër kritere, e më konkretisht:

- 1) “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur”;
- 2) “Aftësitë vendimmarrëse”;
- 3) “Aftësitë e komunikimit”;
- 4) “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore”.

49. Referuar nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në lidhje me emërimet në Gjykatën e Lartë, ndër të tjera, përcaktohet se: “...*Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur...*”. Sipas Vendimit 102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kategori mban parasysh se gjyqtari duhet të ketë aftësi të mira organizative dhe menaxheriale në mënyrë që të jetë produktiv. Në këtë kuptim, kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nuk mund të jetë efektiv pa pasur aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht punën. Produktiviteti, në çdo profesion dhe detyrë, është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mire kandidati përdor kohën e tij, si kur punon vetëm ashtu edhe në grup me të tjerë.

50. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur”:

50.1 Referuar jetëshkrimit, dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, si dhe të dhënave që rezultuan nga intervista me kandidatin, rezultoi se kandidati z. {...} ka një platformë dhe vizion të qartë në lidhje me objektivat nëse zgjidhet anëtar i Gjykatës së Lartë dhe për këtë u administruan:

- Dokumenti përshkruar mbi motivet dhe objektivat nëse emërohet gjyqtar në Gjykatën e Lartë;
- Të dhëna nga intervistimi i kandidatit, më datë 27.02.2020.

50.2 Sipas dokumentit të administruar “Dokumentit përshkruar mbi motivet dhe objektivat nëse emërohet gjyqtar në Gjykatën e Lartë” si dhe intervistës së zhvilluar, Këshilli vlerësoi cilësinë, vlerën dhe origjinalitetin e arsytimit dhe objektivave të prezantuara nga kandidati, ku ai shpalosi programin dhe vizionin e tij mbi qasjen për të realizuar një organizim dhe funksionim cilësor dhe efikas të Gjykatës së Lartë. Këshilli vlerësoi motivet dhe arsytet që e kanë shtyrë kandidatin për të kandiduar për në pozicion vakant pranë Gjykatës së Lartë, që janë pikërisht karriera dhe angazhimi i tij i gjatë, në pozicione të ndryshme si në kodifikim, avokati, mësimdhënie, administratë publike etj, të fokusura në veçanti në fushën e të drejtës penale, por edhe institucionale, të cilat rritin

kuptueshmërinë dhe përkushtimin e tij në lidhje me vetë rolin që ka gjyqtari i Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, formimi dhe eksperiencia e tij në veprimtari “quasi gjyqësore”, si pjesëmarrja në Bordin e Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë, pjesëmarrja si arbitër në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv, si dhe pjesëmarrja si Zëvendëskryetar në ish-Këshillin të Lartë të Drejtësisë, në rastin e shqyrtimit të procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve, rrisnin nivelin mbi përgatitjen dhe adresimin e çështjes në lidhje me juridiksionin e Gjykatës së Lartë. Për objektivat, në rast emërimi në Gjykatën e Lartë, kandidati adresoi zbatimin e parimeve të ushtrimit të pushtetit gjyqësor, vlerat themelore në ushtrimin e funksionit, standartet e etikës dhe zbatimin e rregullave procedurale. Specifikisht, kandidati theksoi rëndësinë që duhet të marrë zhvillimi i praktikës gjyqësore nga Gjykata e Lartë, ulja e ngarkesës së çështjeve që presin për t’u gjykuar në këtë gjykatë, si dhe marrëdhëniet që duhet të krijojë kjo gjykatë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, në funksion të administrimit gjyqësor. Kandidati vlerësoi rolin e Gjykatës së Lartë edhe në shoqëri, sidomos në kuadër zhvillimit të praktikës gjyqësore. Sipas tij, Gjykata e Lartë duhet të zhvillojë praktikë gjyqësore, duke dhënë vendime jo vetëm të arsyetuara, por edhe bindëse e detyruese për të gjithë, përfshirë edhe gjykatat më të ulta. Kandidati ritheksoi edhe gjatë dëgjësës publike problematikën e “backload”-it të Gjykatës së Lartë, çështje me ndjeshmëri të madhe në publik për vetë problematikat që ajo mbart. Kandidati parashtrori masat konkrete që mund të reduktonin “backload”-in e Gjykatës, duke parashtruar së pari, se e rëndësishme ishte vënia në dispozicion e aftësive intelektuale, mendore dhe fizike të gjyqtarit dhe së dyti, duke angazhuar këshilltarët/ndihmësat ligjore dhe duke i specializuar ata në lëndë të ndryshme. Kandidati veçoi si masa më urgjente, atë të shqyrtimit me përparësi dhe zgjidhjes nga Gjykata e Lartë të çështjeve me natyrë emergjente, e më pas, duke grupuar çështjet sipas lëndës, të gjendeshin mundësi për përfshirjen edhe të një stafi të mirëkualifikuar, siç duhet të jetë sipas tij “Njësia e Shërbimit Ligjor”, si struktura që do të ofrojë veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë.

50.3 Nga sa rezultoi, Këshilli vlerësoi: kuptimin e thellë që kandidati ka për rolin e tij si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, sikundër edhe për rolin e kësaj gjykate; vizionin e kandidatit në lidhje me sfidat kryesore me të cilat përballlet Gjykata e Lartë, si nga perspektiva organizative, ashtu edhe e çështjeve thelbësore të së drejtës, si dhe mendimet dhe sugjerimet konkrete të kandidatit për t’i adresuar këto sfida.

50.4 Ndaj nga sa më lart, për kriterin e vlerësimit “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

51. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë vendimmarrëse”:

51.1 Referuar jetëshkrimit, dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, si dhe të dhënave që rezultuan nga intervista me kandidatin, rezultoi se kandidati z. {...} ka aftësitë të fituara në përvojën, pozicionet dhe përgjegjësitë e mbuluara, në lidhje me aspektet që kanë të bëjnë me

menaxhimin, planifikimin dhe administrimin e punës dhe për këtë u administrua dokumentacioni që ka të bëjë me:

- Eksperiencën në pozicionin e Përgjegjës të Departamentit të Drejtësisë në Shkollën e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti” - Vlerësimi i punës së kandidatit në këtë insitucion të arsimit të lartë paraqitet edhe në Opinionin Vlerësues të përmendur më lart;
- Eksperiencën në pozicionin e Zëvendëskryetarit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë - Përveç dokumenteve publike dhe atyre që gjenden në Këshillin e Lartë Gjyqësor, eksperiencia e kandidatit evidentohet dhe në një botim të dorëzuar nga ai;
- Eksperiencën si anëtar/arbitër i Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) - Eksperiencia evidentohet në veprimtarinë dhe aktet e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv, disa nga të cilat janë dorëzuar nga kandidati;
- Eksperiencën si ekspert i UNICEF - Vlerësimi i punës në këtë ambient multikulturor dhe multidisiplinor paraqitet edhe në Vlerësimin e Produktit për Konsulentë dhe Kontraktorë Individual të Unicef; si dhe në Certifikatën e akorduar lidhur me “Etikën dhe integritetin në Unicef”;
- Eksperiencën si pedagog në Shkollën e Magjistraturës - Puna dhe aftësitë evidentohen nga fakti që kandidati ka qenë pedagog që prej krijimit të Shkollës së Magjistratures, fillimisht si pedagog i brendshëm dhe, më pas, i jashtëm, në formimin fillestar, ekspert në trajnimet e formimit vazhdues, por edhe nga fakti i zgjedhjes së tij si kandidat nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës për të konkurruar si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Eksperiencën si ekspert i nivelit të lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar në Kuvendin e Shqipërisë për Reformën në Sistemin e Drejtësisë - Vlerësimi i punës paraqitet edhe në Dokumentet e Kuvendit të Shqipërisë për Reformën në Sistemin e Drejtësisë;
- Eksperiencën si anëtar i Bordit Editorial për Botimin e Kuvendit të Shqipërisë “Reforma në Sistemin e Drejtësisë” - Vlerësimi i punës paraqitet edhe në Dokumentet e Kuvendit të Shqipërisë (të Bordit Editorial) për Reformën në Sistemin e Drejtësisë;
- Eksperiencën si anëtar i Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë - Vlerësimi i punës në këtë ambient multidisiplinor dhe multikulturor paraqitet edhe në Opinionin Vlerësues të këtij Bordi, të përmendur më lart;
- Të dhëna nga intervistimi i kandidatit, më datë 27.02.2020.

51.2 Sipas dokumenteve të administruara, rezultoi se kandidati {...} ka pasur pozicione të ndryshme pune si pedagog, arbitër, konsulent, anëtar bordi në person juridik privat, ekspert për çështje të së drejtës penale etj. Duke pasur në konsideratë edhe përgjegjësitë që ai ka mbuluar në këto pozicione të ndryshme dhe të rëndësishme edhe në jetën publike, Këshilli vlerësoi se kandidati

paraqet aftësi shumë të mira menaxhuese, planifikuese dhe në administrimin e punës. Këshilli në këtë pikë, mbajti në konsideratë edhe faktin se kandidati ka mbajtur dhe mban pozicione drejtuese, ku aftësitë vendimmarëse shpalosen më shumë. Gjithashtu, gjatë intervistës, kandidati tregoi vendosmëri në lidhje me çështje të ndryshme që kishin nevojë për zgjidhje për funksionimin sipas ligjit të Gjykatës së Lartë, duke theksuar nismat dhe vendimmarrjet që duhet të merreshin në kuadër të “backload”-it të Gjykatës së Lartë, në kuadër të organizimit dhe përmirësimit të burimeve njerëzore dhe stafit ndihmës si dhe shndërrimin e saj në një Gjykatë që “zhvillon praktikën gjyqësore”, që jep vendime të arsyetuara dhe bindëse, cilësi këto që vendosin një siguri në rendin juridik.

51.3 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Aftësitë vendimmarëse”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 4 pikë.

52. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë e komunikimit”:

52.1 Referuar jetëshkrimit, dokumentacionit të administruar gjatë procedurës të cilat shërbyen edhe për vlerësimin e kriterit “Aftësitë vendimmarëse”, si dhe të dhënave që rezultuan nga intervista me kandidatin, rezultoi se kandidati z. {...} ka aftësi shumë të mira për t’u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize. Rezultoi që kandidati të ketë punuar në pozicione të ndryshme pune, përfshirë në administratën publike dhe në sektorin privat, apo edhe përfshirjen në shumë projekte me të huaj, zhvilluar nga organizata ndërkombëtare të ndodhura në Shqipëri, të vlerësuara këto dhe me referencat e përcjella nga drejtues të institucioneve dhe organizatave të ndryshme ku kandidati punon apo ka punuar, sipas të cilave tregohet se ai komunikon me të tretët në mënyrë jodiskriminuese, të matur dhe me respekt. Gjithashtu, aftësitë e tij të komunikimit u shpalosën qartë edhe në seancën dëgjimore përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku kandidati u përgjigj në mënyrë të qartë dhe koncize në lidhje me pyetjet e parashtruara nga anëtarët. Ai komunikoi me etikë, në mënyrë të matur dhe me respekt. Kandidati kuptoi drejt pyetjet e bëra nga anëtarët e Këshillit dhe iu përmbajt kontekstit në të cilën u parashtruan pyetjet e bëra. Ai reflekton vendosmëri dhe vetëbesimin në sipërmarrjen që ka marrë përsipër, duke folur me efektivitet me qëllim që të kuptohet nga të tjerët dhe personave që iu drejtohet, cilësi kjo shumë e rëndësishme për mënyrën sesi funksionon dhe vetë Gjykata e Lartë.

52.2 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Aftësitë e komunikimi”, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

53. Vlerësimi dhe pikëzimi për kriterin “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore”:

53.1 Referuar jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës, rezultoi se kandidati z. {...} ka vijueshmëri në punë të zhvilluara në ekip dhe punë në ambiente multidisiplinore dhe për këtë u administrua dokumentacioni që ka të bëjë me pjesëmarrjet si:

- Anëtar i Grupit të Punës për Përafrimin e Legjislacionit Shqiptar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Projekt i Këshillit të Evropës), në vitet 1997 dhe 2000-2001 - Produkt i këtij angazhimi është edhe Raporti mbi Studimin e Përjasjes së Legjislacionit Shqiptar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Anëtar i Grupit të Punës për Përafrimin e Legjislacionit Shqiptar me Konventën Evropiane për të Miturit në Shqipëri (Projekt i UNICEF-United Nations Children’s Fund), në vitin 2000 dhe Koordinator i Grupit të Punës për ndryshimin e legjislacionit ekzistues për Drejtësinë për të Miturit në Shqipëri dhe përafrimin e tij me Konventat Ndërkombëtare dhe aktet e tjera ndërkombëtare, si dhe i Grupit të Trajnimeve për Drejtësinë për të Miturit (Projekt i UNICEF), në vitin 2001 - Ky angazhim konfirmohet me Shkresën e datës 13.01.2020, të Zyrës së UNICEF Albania;
- Anëtar i Grupit të Punës dhe Trajnues në Projektin e trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të zonave verilindore të Shqipërisë (Projekt i Fondacionit DANIDA), në vitin 2001 - Produkt i këtij angazhimi është edhe Revista Ligjore “Trajtime Juridike”, ku është botuar punimin me temë “Gjykimet e posaçme”;
- Anëtar i Grupit të Punës për “Shqyrtimin e Mosdiskriminimit në këndvështrimin e Paktit të Stabilitetit të Evropës Juglindore” (Projekt i Këshillit të Evropës), në vitet 2002-2003. - Ky angazhim konfirmohet me Shkresën datë 30.01.2020, të Zyrës së Këshillit të Evropës në Shqipëri;
- Redaktor i Buletinit Ligjor mbi jurisprudencën e vendimeve të Gjykatës për të Drejtat e Njeriut, në Strasburg (Projekt i Këshillit të Evropës dhe i Qendrës Evropiane në Shqipëri), në vitet 2001-2006 - Produkt i këtij angazhimi është edhe Botimi “Të drejtat e njeriut në Europë”, Buletin Ligjor mbi jurisprudencën e vendimeve të Gjykatës për të Drejtat e Njeriut, në Stasburg (Projekt i Qendrës Evropiane Tiranë, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, mbështetur nga Këshilli i Evropës dhe Komisioni European), Botimi nr. 1, nr. 2 dhe nr. 12, të vitit 2001;
- Pjesëmarrës dhe bashkëdrejtues në Projektin e Binjakëzimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të Shqipërisë me Këshillat e Larta të Gjyqësorit të Italisë dhe Spanjës. Projekt i Bashkimit Evropian, në vitet 2005-2007 - Produkt i angazhimit në këtë projekt është dhe Botimi¹ “Këshilli i Lartë i Drejtësisë”, botim i vitit 2007, i cili është realizuar me fondet e Agjensisë Spanjolle për Bashkëpunim Ndërkombëtar (AECI);
- Pjesëmarrës si ekspert në Projektin “Mbi zbatimin e masterplanit Sistemi shqiptar i paraburgimit 2005-2008. Situata aktuale dhe sfidat”, organizuar nga Instituti Evropian i Tiranës, përgjatë vitit 2010 - Produkt i këtij angazhimi është edhe Botimi “Mbi zbatimin e masterplanit-Sistemi shqiptar i paraburgimit (2005-2008). Situata aktuale dhe sfidat”;

¹¹ Ky botim gjendet edhe pranë Bibliotekës së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

- Pjesëmarrës si ekspert në Projektin “Për kujdesin ndaj shëndetit mendor në burgje në Shqipëri”, (pjesëmarrje në procesin e hartimit të Ligjit të ri “Për shëndetin mendor”, në takime dhe konferenca të ndryshme) organizuar nga Instituti Evropian i Tiranës, përgjatë vitit 2013 - Produkt i këtij angazhimi është edhe Botimi “Për kujdesin ndaj shëndetit mendor në sistemin e burgjeve në Shqipëri”;
- Pjesëmarrës në projektin “Forcimi i sistemit të drejtësisë për të rinjtë në Shqipëri”. Projekt i “Save the Children” dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, në vitin 2014 - Ky angazhim konfirmohet me Shkresën datë 14.01.2020, të Fondacionit “Save the Children”;
- Pjesëmarrës në Programin trajnues të efektivave të Policisë së Shtetit për të drejtat e personave të arrestuar, të ndaluar apo të shoqëruar dhe respektimi i tyre nga policia. Projekt i Institutit Evropian të Tiranës, Pameca IV dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në vitet 2014-2015 - Produkt i këtij angazhimi është edhe Botimi/Manuali “Të drejtat e personave të arrestuar, të ndaluar apo të shoqëruar dhe respektimi i tyre nga Policia e Shtetit”;
- Pjesëmarrës në hartimin dhe zhvillimin e një Dokument Strategjik mbi një Drejtësi miqësore për fëmijë, për të informuar dhe ndikuar në Strategjinë e Reformës së Sistemit të Drejtësisë, në vitin 2015. (Organizimi nga UNICEF) - Produkt i këtij angazhimi është dhe Punimi “Dokument Strategjik mbi Drejtësinë Miqësore për të Mitur”;
- Pjesëmarrës si ekspert pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar në Kuvendin e Shqipërisë për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, 2015-2016 - Produkti i këtij angazhimi, ndër të tjera, është pasqyruar edhe në Botimin “Reforma në sistemin e drejtësisë”, Vëllimi I, Pjesa e parë, botim i Kuvendit të Shqipërisë (faqe 159);
- Anëtar i Grupit të Punës për hartimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur të Republikës së Shqipërisë, në vitet 2016-2017. (Organizuar nën kujdesin e UNICEF dhe Kuvendit të Shqipërisë) - Produkt i këtij angazhimi është edhe Projekti i Kapitujve V-VII të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;
- Anëtar i Bordit Editorial për botimin “Reforma në Sistemin e Drejtësisë”. Botim i Kuvendit të Shqipërisë, nga viti 2017 - Produkti i këtij angazhimi, ndër të tjera, është pasqyruar edhe në Botimin “Reforma në sistemin e drejtësisë”, Vëllimi I, Pjesa e parë, botim i Kuvendit të Shqipërisë;
- Konsulent në Projektin e UNICEF “Mbështetje e Ministrisë së Drejtësisë dhe e institucioneve të tjera kombëtare në implementimin e kornizës ligjore të Drejtësisë për të Mitur”, 2019-në vazhdim - Ky angazhim konfirmohet me Shkresën e datës 13.01.2020 të Zyrës së UNICEF Albania;
- Anëtar i Grupit të Punës për hartimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, në vitet 1992-1995 (Organizimi nën kujdesin dhe ndihmën e Këshillit të

Evropës), si dhe takime ekspertësh mbi të drejtën procedurale penale, organizuar nga Këshilli i Evropës, në Tiranë (Shqipëri), Romë (Itali) dhe Budapest (Hungari) në vitet 1993, 1994 dhe 1995;

- Anëtar i Grupit të Punës për Përafrimin e Legjislacionit Shqiptar me Konventën Evropiane për të Miturit në Shqipëri (Projekt i UNICEF-United Nations Children's Fund), në vitin 2000;
- Redaktor ligjor i botimit në gjuhën shqipe të Manualit për Gjykimin e Drejtë (Projekt i Amnesty International), në vitin 2001;
- Pjesëmarrës dhe bashkëdrejtues në Projektin e Bankës Botërore për Konsolidimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, në vitet 2003-2006.

53.2 Sipas dokumenteve të administruara, rezultoi se kandidati ka mbi 28 vjet pune, gjatë së cilës në vijimësi ka patur eksperiencë pune në grup dhe në ambiente multidisiplinore, ç'ka tregon se ai ka aftësitë e nevojshme për të punuar në kolegje sikurse Gjykata e Lartë funksionon. Duke vlerësuar se ai ka punuar shpesh në ambiente multidisiplinore dhe punë në grup, referuar edhe vlerësimeve të përcjella nga drejtuesit e institucione përkatëse që kanë vlerësuar punën, kompetencat dhe aftësitë e kandidatit për të punuar në grup, si dhe duke pasur në konsideratë faktin se ai është promovuar shpesh në projekte të ndryshme edhe me ndërkombëtarët, Këshilli çmoi se kandidati është i përshtatshëm për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, pasi reflekton kompetencë dhe aftësi për të punuar në kolegje me gjyqtarë të tjerë, për të shkëmbyer lirshëm dhe në mënyrë efektive pikëpamjet me kolegët dhe disponueshmërinë për të negociuar mospërputhjen e pikëpamjeve, nëse këto shfaqen. Sipas Këshillit, bazuar edhe në përgjigjet e dhëna gjatë intervistës, kandidati {...} demonstron një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësi për të qenë pjesë e një komuniteti pune, pra aftësinë për të punuar në ekipe me kolegët dhe anëtarët e stafit.

53.3 Ndaj nga sa rezultoi, për kriterin e vlerësimit “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore”, duke vlerësuar eksperiencën e kandidatit gjatë karrierës, në punën në ekip dhe në ambiente multidisiplinore, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmoi se kandidati duhet të vlerësohet me 2 pikë.

54. Sa më lart, në përfundim të arsyetimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për secilën kategori, kriter, nënkriter dhe tregues, Këshilli i Lartë Gjyqësor e vlerësoi kandidatin {...} në total me 86 (tetëdhjetë e gjashtë) pikë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikat 1-6, Seksioni D, Kreu VI, të Vendimit të tij nr.102,

datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, si dhe në Vendimin e tij nr.209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit z. {...}, si më poshtë:

A. Kategoria “Meritat profesionale”:

1. Kriteri “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”:

- a) Nënkriteri “Rezultatet e studimeve të larta në drejtësi” - 2 pikë;
- b) Nënkriteri “Rezultatet e programeve të formimit fillestar” - 0 pikë;
- c) Nënkriteri “Rezultatet e përvojës në profesion” - 4 pikë;
- ç) Nënkriteri “Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë”:
 - i) Treguesi “Rezultatet e trajnimeve të tjera” - 0 pikë;
 - ii) Treguesi “Rezultatet e kualifikimeve pasuniversitare” - 2 pikë;
 - iii) Treguesi “Rezultatet e gradave/titujve shkencorë” - 2 pikë;
- d) Nënkriteri “Aftësitë gjuhësore” - 2 pikë;

2. Kriteri “Kualifikimi i përgjithshëm profesional”:

- a) Indikator “Origjinaliteti dhe/ose impakti” - 5 pikë;
- c) Indikator “Aftësitë analitike dhe hulumtuese” - 5 pikë;
- c) Indikator “Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja” - 5 pikë;
- ç) Indikator “Interpretimi i harmonizuar” - 5 pikë;
- d) Indikator “Referencat e praktikës gjyqësore” - 5 pikë;

3. Kriteri “Kualifikimi shtesë profesional”:

- a) Nënkriteri “Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike” - 6 pikë;
- b) Nënkriteri “Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike” - 6 pikë;
- c) Nënkriteri “Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit” - 4 pikë;
- ç) Nënkriteri “Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj”:

- | | |
|---|-----------|
| i) Treguesi “Pjesëmarrja në konferenca shkencore” | - 4 pikë; |
| ii) Treguesi “Mësimdhënie” | - 4 pikë; |
| iii) Treguesi “Çmime dhe tituj” | - 0 pikë; |
- B. Kategoria “Meritat morale dhe etike”:
- | | |
|---|-----------|
| 1. Kriteri “Shmangia e shfaqjes së pahijshme” | - 5 pikë; |
| 2. Kriteri “Nderi dhe dinjiteti” | - 5 pikë; |
| 3. Kriteri “Reputacioni” | - 5 pikë; |
- C. Kategoria “Meritat organizative dhe menaxheriale”:
- | | |
|---|-----------|
| 1. Kriteri “Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur” | - 2 pikë; |
| 2. Kriteri “Aftësitë vendimmarrëse” | - 4 pikë; |
| 3. Kriteri “Aftësitë e komunikimit” | - 2 pikë; |
| 4. Kriteri “Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore” | - 2 pikë; |
- Totali - 86 pikë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR